

PISA SI PASQYRË:

SFIDAT E ARSIMIT
NË KOSOVË

PISA si pasqyrë: Sfidat e arsimit në Kosovë

Autor:

Dukagjin Pupovci

Redaktore gjuhësore:

Afrore Lila

Dizajn:

Envinion

Publikuar nga:

Qendra për Arsim e Kosovës (KEC)
Kompleksi i Shkollës “Mileniumi i Tretë”
rr. “Qëndresa” nr. 48, Matiçan,
10000 Prishtinë, Kosovë
www.kec-ks.org
office@kec-ks.org



**OPEN SOCIETY
FOUNDATIONS**
WESTERN BALKANS

Shënim: Ky hulumtim është pjesë e projektit “Përkrahja e arsimit të lartë përmes avokimit dhe kontributit të bazuar në hulumtim” i mbështetur nga Fondacioni i Ballkanit Perëndimor për Shoqëri të Hapur në kuadër të projektit.

Pikëpamjet e shprehura në këtë hulumtim janë të autorit dhe nuk paraqesin medoemos pikëpamjet e Fondacionit të Ballkanit Perëndimor për shoqëri të hapur.

Përmbajtja

1. Hyrje.....	4
2. Çka është PISA?.....	6
3. Përgatitjet për PISA 2022.....	8
4. Rezultati i PISA 2022.....	10
5. Barazia në arsim	18
5.1. Aspektet gjinore	18
5.2. Statusi socio-ekonomik	20
5.3. Pjesëmarrja në edukimin parashkollor.....	24
5.4. Tipi dhe lokacioni i shkollës	25
6. Qëndrimet e nxënësve, mësimdhënia dhe të nxënit	28
6.1. Ankthi nga matematika	28
6.2. Çfarë dinë nxënësit nga matematika?	31
6.3. Mësimdhënia dhe të nxënit.....	33
6.4. Qëndrimet rreth karrierës.....	35
7. Klima shkollore	36
7.1. Siguria dhe sjellja e nxënësve	36
7.2. Bullizmi	38
7.3. Disiplina në orët e matematikës	40
8. Burimet njerëzore dhe materiale.....	42
8.1. Shpenzimet për arsim	42
8.2. Burimet njerëzore	43
8.3. Burimet materiale	47
9. Ndikimi i Pandemisë COVID-19	52
10. Përmbledhje e gjetjeve të studimit	56
11. Rekomandimet.....	60

1. Hyrje

Përfshirja e Kosovës në Programin për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve (PISA) të zhvilluar nga Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) ishte një hap i rëndësishëm drejt vlerësimit të sistemit arsimor të vendit në një skenar ndërkombëtar. Megjithatë, rezultatet e dobëta të nxënësve kosovarë në tri ciklet e fundit të këtij vlerësimi, përkatësisht vitet 2015, 2018 dhe 2022, nxitën nevojën për një analizë të thelluar mbi shkaqet që qëndrojnë pas këtyre rezultateve, dhe mbi mënyrat se si mund të ndërmerren hapa konkretë për përmirësimin e situatës.

Ky studim u realizua duke u bazuar në analizën e raporteve të PISA të publikuara nga OECD, si dhe në vlerësimin e dokumenteve dhe të dhënave tjera që janë bërë publike në këtë kontekst. Për shkak të vëllimit të madh të të dhënave, analiza është kufizuar në disa segmente të veçanta të interesit. Këta përfshijnë trendët e performancës së nxënësve në lëndët kryesore - leximi, matematika dhe shkenca - gjatë tri cikleve të përmendura më lart.

Në mënyrë specifike, studimi ka përfshirë analizën e të dhënave mbi gjendjen në familje, në shkolla dhe në komunitete, si dhe perceptimet dhe qëndrimet e nxënësve e të drejtorëve të shkollave, të cilat janë mbledhur përmes anketave specifike, të realizuara gjatë periudhës së testimit. Këto analiza janë bërë në raport me performancën e nxënësve në matematikë, e cila ka qenë disiplina qendrore në PISA 2022. Studimi është përqendruar në analizën e aspekteve të ndryshme si: barazia në arsim, qëndrimet e nxënësve që ndërlidhen me ankthin nga matematika, përgatitja dhe perceptimet e tyre për mësimdhënien e matematikës, dhe qëndrimet në raport me karrierën. Studimi ka trajtuar edhe aspekte të tjera të rëndësishme si klima shkollore, duke përfshirë sigurinë dhe sjelljen e nxënësve, bullizmin dhe disiplinën në orët e matematikës, si dhe burimet njerëzore e materiale, duke u përqendruar në shpenzimet për arsim, kualifikimin dhe zhvillimin profesional të mësimdhënësve, dhe infrastrukturën fizike dhe materialet mësimore. Ndikimi i mundshëm i pandemisë COVID-19 në performancën e nxënësve ka qenë gjithashtu një fokus kyç i këtij hulumtimi.

Krahasimet janë bërë jo vetëm me mesataren e OECD-së, por edhe me vendet fqinje të Kosovës, si Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia, që të jepet një kontekst më i gjerë i performancës dhe i sfidave me të cilat përballen sistemi arsimor i Kosovës. Për korrektësi dhe transparencë, është bërë përpjekje që të prezantohen pyetjet nga anketat për nxënës dhe për drejtorë të shkollave **në formën e tyre origjinale të versionit shqip për Kosovën**, edhe përkundër asaj se kemi besuar që ndonjë redaktim do t'i bënte më të kuptueshme për respondentët.

Gjetjet dhe analizat e hulumtimit janë përmbledhur në kapitullin e 11-të, ndërsa rekomandimet bazuar në këto gjetje janë dhënë në kapitullin 12. Këto rekomandime janë ndarë në gjashtë kategori kyçe që synojnë përmirësimin e arsimit në Kosovë: 1) Kurrikula dhe materialet mësimore; 2) Sigurimi i brendshëm dhe i jashtëm i cilësisë; 3) Furnizimi i shkollave me mjete dhe materiale mësimore; 4) Cilësia e mësimdhënies në shkolla; 5) Klima disiplinore në shkolla; 6) Rishikimi i sistemit të financimit në arsimin parauniversitar.

Analiza e këtij studimi është mbështetur në burimet në dispozicion publik të ofruara nga OECD, dhe në bazat e të dhënave të PISA për vitet 2015, 2018, dhe 2022 duke përdorur veçanërisht platformën “online” PISA Data Explorer¹, që të krijohen analiza të veçanta dhe të ndërtohen raporte, bazuar në këto të dhëna. Për një vlerësim më të detajuar të informacionit, janë shfrytëzuar të dhënat në dispozicion në formatin tabelor², ndërkaq analiza është realizuar duke përdorur SPSS. Megjithëse përqendrimi në të dhënat sasiore ofron një pasqyrë të gjerë e të qartë të performancës së nxënësve kosovarë në kontekstin ndërkombëtar të PISA-s, kufizimi në këtë lloj të të dhënave paraqet një pengesë të studimit. Kjo metodologji nuk mund të kapë plotësisht thellësinë dhe kompleksitetin e faktorëve që ndikojnë në arsim, duke lënë hapësirë për një nevojë të analizave të mëtejshme që të integrojnë perspektiva cilësore e të kuptohen më mirë dinamikat dhe sfidat brenda sistemit arsimor të Kosovës.

¹ PISA Data Explorer. <https://pisadataexplorer.oecd.org/ide/idepisa/>

² PISA 2022 SPSS Data Files- <https://www.oecd.org/pisa/data/2022database/>

2. Çka është PISA?

PISA, i njohur si Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve, është një studim i nisur në vitin 2000 nga Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD). Ky program ka për qëllim të vlerësojë sistemet arsimore nëpër botë duke testuar njohuritë dhe aftësitë e nxënësve 15-vjeçarë në shtete dhe ekonomi të ndryshme³. Që nga viti 2000, PISA ka përfshirë mbi 100 shtete dhe ekonomi në ciklet e saj të testimit. Testet e PISA zhvillohen çdo tre vjet dhe përfshijnë pyetje në lexim, matematikë dhe shkencë, me një përqendrim të veçantë në një prej këtyre fushave në çdo cikël vlerësimi. Për shembull, përqendrimi ishte në lexim në vitin 2000, në matematikë në 2003, në shkencë në 2006, dhe kështu me radhë. Testi i vitit 2022 me fokus në matematikë ishte i planifikuar të mbahet një vit më herët, por u shty për shkak të pandemisë COVID-19. Kosova ka marrë pjesë në ciklet e vitit 2015, 2018 dhe 2022.

Testet e PISA nuk janë të lidhura drejtpërdrejt me kurrikulën shkollore dhe janë të dizajnuara për të vlerësuar se si nxënësit, në fund të arsimit të detyrueshëm, aplikojnë njohuritë e tyre në situata reale të jetës. Shumica e pyetjeve në testet PISA janë me zgjedhje të shumëfishta, por rreth një e treta e tyre janë pyetje të hapura. Pyetjet e PISA hartohen nga ekspertët e shteteve pjesëmarrëse dhe të OECD-së. Ato kontrollohen për paragjykime dhe vetëm ato që kalojnë këtë test përdoren në PISA. Gjithashtu, realizohet një test provues në të gjitha shtetet pjesëmarrëse para se të mbahet testi kryesor, që të bëhen korrigjimet e duhura.

Nxënësit që marrin pjesë në PISA, jo vetëm që përgjigjen në pyetje të ndryshme të testit, por gjithashtu plotësojnë pyetësorë të detajuar. Këta pyetësorë mbledhin informacione të rëndësishme rreth: atyre si individë, mjedisit të tyre familjar, angazhimit në procesin mësimor, si dhe qëndrimeve ndaj mësimit e shkollës. Ky informacion shtesë është i vlefshëm, që të kuptohet më mirë konteksti në të cilin zhvillohet mësimi dhe mënyra sesi ky kontekst mund të ndikojë në performancën e nxënësve. Po ashtu, drejtorët e shkollave plotësojnë pyetësorin që jep të dhëna të rëndësishme rreth institucioneve të tyre, duke ndihmuar në identifikimin e faktorëve institucionalë e që mund të kenë ndikim në performancën e nxënësve. Në disa shtete, edhe mësimdhënësit dhe prindërit plotësojnë pyetësorë të ngjashëm, duke ofruar një sfond më të plotë të mjedisit arsimor dhe të faktorëve që ndikojnë në mësim. Ndërlidhja e të dhënave të mbledhura nga këta pyetësorë me rezultatin e testit është një aspekt kyç i analizës në PISA. Kjo ndërlidhje mundëson zbulimin e tendencave dhe modeleve, si dhe krijimin e lidhjeve midis performancës akademike dhe faktorëve siç janë: statusi socio-ekonomik, disponueshmëria e burimeve

³ Termi "ekonomi" në kontekstin e PISA përdoret për të përshkruar entitetet pjesëmarrëse që nuk janë shtete të pavarura, por janë pjesë të shteteve të tjera. Kjo përfshin disa rajone ose provinca brenda një shteti që marrin pjesë në PISA si entitete të ndara. Për shembull, në Kinë, rajone si Pekin, Shanghai, Guangdong, Zhejiang, Jiangsu, si dhe territoret e veçanta administrative si Macao dhe Hong-Kong, marrin pjesë në PISA si entitete të veçanta, jo si pjesë e Kinës si një tërësi. Një situatë e ngjashme vërehet edhe me disa provinca të Indisë.

mësimore, mbështetja prindërore, motivimi i nxënësve, si dhe qëndrimet dhe perceptimet e tyre ndaj shkollës dhe mësimi.

Testi PISA ka për qëllim të vlerësojë performancën e sistemeve arsimore dhe jo të nxënësve individualë. Prandaj, jo të gjithë nxënësit marrin të njëjtat pyetje. Në fushat si shkenca, caktimi i formave të testit është plotësisht rastësor, ndërsa në matematikë dhe lexim, testet janë të përshtatura. Kjo do të thotë që pyetjet fillestare zgjidhen rastësisht, por pyetjet e mëtejshme përcaktohen në bazë të performancës së nxënësit në pjesën fillestare të testit. Kjo metodë siguron që nxënësit me performancë të lartë të përballen me pyetje më të vështira, ndërsa ata me performancë më të ulët me pyetje më të lehta. Mostra e nxënësve dhe shkollave të përfshira në PISA është zgjedhur në mënyrë rastësore dhe është reprezentative për shtetin, por jo domosdoshmërisht për çdo shkollë. Kjo nënkupton se **rezultatet e PISA nuk raportohen në nivel të shkollave individuale.**

PISA ka një metodologji të veçantë dhe komplekse për vlerësimin e përgjigjeve të nxënësve në pyetjet e testit. Në vend që të llogaritet thjesht numri i përgjigjeve të sakta, PISA përdor një metodë statistikore për vlerësimin e aftësisë së nxënësit në fusha si leximi, matematika dhe shkenca, duke marrë parasysh vështirësinë e çdo pyetjeje. Në vend të një vlerësimi të vetëm me pikë, PISA nxjerr disa vlerësime me pikë “të mundshme” (plausible values) për çdo nxënës, të cilat paraqesin një gamë të mundshme të aftësive që nxënësi mund të ketë, bazuar në përgjigjet e tij. Pikët në PISA janë të rregulluara në mënyrë që të jenë të krahasueshme ndër vite të ndryshme. Vlerësimi me pikë bëhet ashtu që mesatarja e pikëve të jetë gjithmonë rreth 500. Kjo metodë siguron që rezultatet nga vende dhe kontekste të ndryshme të jenë të krahasueshme, duke ofruar një pasqyrë të qartë të performancës së sistemeve arsimore në nivelin ndërkombëtar.

Deri vonë, ka qenë e zakonshme të aplikohet një barsvlerësi e një viti shkollor me 40 pikë në PISA. Kjo metrikë është përdorur për ilustrimin e dallimeve në arritjet midis kategorive të ndryshme të nxënësve të testuar në PISA. Për shembull, nëse një kategori nxënësish arrinte 440 pikë dhe një tjetër vetëm 380 pikë, kjo është interpretuar si një ndryshim prej rreth 1.5 vitesh shkollimi midis dy grupeve. Sidoqoftë, studime të kohëve të fundit tregojnë se përfitimet vjetore në mësim ndryshojnë ndjeshëm nga një vend në tjetrin. Në matematikë, për shembull, sipas Avvistati dhe Givord⁴, rezulton se pikët e testit të nxënësve për një vit shkollimi në Austri, Skoci dhe Singapor rriten rreth dy herë më shpejt se sa ato të nxënësve në Brazil dhe Malajzi. Prandaj, **nuk rekomandohet më që të konvertohen pikët e PISA në vite shkollimi**, pasi kjo nuk pasqyron saktësisht përfitimet nga vitet e shkollimit në kontekste të ndryshme.

4 Avvistati F., Givord P.: The learning gain over one school year among 15-year-olds: An international comparison based on PISA. Labour Economics Volume 84, October 2023, 102365. <https://www.sciencedirect.com/science/article/abs/pii/S0927537123000404>

3. Përgatitjet për PISA 2022

Pas përfundimit të testit PISA në vitin 2018, u ndërmorën hapa për organizimin e testit PISA që ishte planifikuar të mbahet në vitin 2021, me një fokus të veçantë në fushën e matematikës. Sidoqoftë, për shkak të pandemisë COVID-19, testimi u shty për një vit. Procesit të testimit i ka paraprirë hartimi i një kornize vlerësuese dhe analitike të gjithanshme e të detajuar për ciklin e vitit 2022 të PISA-s⁵. Korniza përqendrohet më shumë në fushën kryesore të testit (Matematika), natyrën e kërkesave (pyetjeve) të testit dhe qasjen ndaj vlerësimit të performancës së nxënësve në këtë fushë, duke përshkruar bazën teorike të kërkesave të vlerësimit dhe kompetencat që synojnë të maten. Ndërkaq, për fushën e leximit dhe për fushën e shkencës shfrytëzohen kornizat e ciklit PISA të vitit 2018 përkatësisht 2015 kur këto disiplina kanë qenë në fokus.

Në matematikë, PISA mat aftësinë e individit për rezonin matematikor si dhe për të formuluar, përdorur dhe interpretuar matematikën për zgjidhjen e problemeve në një sërë kontekstesh të ndryshme reale. Korniza përfshin koncepte, procedura, fakte dhe mjete për përshkrimin, shpjegimin dhe parashikimin e fenomeneve. Ajo ndihmon individët të njohin rolin që luan matematika në botë dhe të bëjnë gjykime dhe vendime të mirë-bazuara, që janë të nevojshme për qytetarët konstruktivë, të angazhuar dhe reflektues të shekullit 21.

Vlerësimi i leximit në PISA mat aftësinë e individit për të kuptuar, përdorur, vlerësuar, reflektuar dhe bashkëvepruar me tekste për arritjen e qëllimeve të veta, me qëllim që të zhvillojë njohuritë dhe potencialin vetjak, dhe të marrë pjesë në jetën shoqërore.

Vlerësimi i shkencës në PISA mbulon aftësinë për t'u angazhuar me çështjet e lidhura me shkencën dhe me idetë e shkencës si një qytetar reflektues. Një person që e kupton shkencën është i gatshëm të përfshihet në debate të argumentuara rreth shkencës dhe teknologjisë, gjë që kërkon kompetencë për shpjegimin e fenomeneve në mënyrë shkencore, për ngritjen e çështjeve me bazë në shkencë, si dhe për interpretimin e të dhënave dhe provave shkencërisht.

Testi PISA 2022 në Kosovë është zhvilluar përmes përdorimit të kompjuterit. Pyetjet e testit janë përkthyer në gjuhën shqipe dhe janë përshtatur deri në një masë me terminologjinë specifike që përdoret në Kosovë. Çdo pyetje në test ka përfshirë disa nënpyetje të ndërlidhura me njëra-tjetrën që të krijohej një kontekst i plotë. Që të ilustron formati e struktura e pyetjeve në test, si shembull, paraqiten tri nënpyetjet e pyetjes me temë «Modelet trekëndore»⁶.

5 PISA 2022 Assessment and Analytical Framework. <https://www.oecd.org/publications/pisa-2022-assessment-and-analytical-framework-dfe0bf9c-en.htm>

6 Përgjigjet e sakta: 1/3) 37.5%; 2/3) 40%; 3/3) Po, sepse në çdo rresht të modelit, përfshirë rreshtat që shtohen, numri i trekëndëshave të kuq është për një më i madh se numri i trekëndëshave të kaltër.



Modelet Trekëndore

Pyetje 1 / 3

Referohuni "Modele Trekëndore" në të djathtë. Klikoni një alternativë për t'ju përgjigjur pyetjes.


Sa përqind të trekëndëshave në katër radhët e para të figurës së Aleksit janë të kaltër?

- 37.5%
 50.0%
 60.0%
 62.5%

MODELET TREKËNDORE

Aleksi i vizatoi modelet në vijim të trekëndëshave të kuq dhe të kaltër.

Katër radhët e para të figurës janë paraqitur më poshtë.



Modelet Trekëndore

Pyetje 2 / 3

Referohuni "Modele Trekëndore" në të djathtë. Klikoni një alternativë për t'ju përgjigjur pyetjes.


Nëse Aleksi do ta zgjeronte figurën në radhën e pestë, sa do të ishte përqindja e trekëndëshave të kaltër në të gjitha pesë radhët e figurës?

- 40.0%
 50.0%
 60.0%
 66.7%

MODELET TREKËNDORE

Aleksi i vizatoi modelet në vijim të trekëndëshave të kuq dhe të kaltër.

Katër radhët e para të figurës janë paraqitur më poshtë.



Modelet Trekëndore

Pyetje 3 / 3

Referohuni "Modele Trekëndore" në të djathtë. Kliko një opsion dhe pastaj shkruaje një sqarim për t'ju përgjigjur në pyetje.

Aleksi do të shtojë akoma radhë në modelin e tij.

AI pretendon se përqindja e trekëndëshave të kaltër në model do të jetë gjithmonë më e vogël se 50%.

A ka Aleksi të drejtë?


- Po
 Jo

Sqaroeni përgjigjen tuaj.

MODELET TREKËNDORE

Aleksi i vizatoi modelet në vijim të trekëndëshave të kuq dhe të kaltër.

Katër radhët e para të figurës janë paraqitur më poshtë.



4. Rezultati i PISA 2022

Studimi PISA 2022 u zhvillua me pjesëmarrjen e afërsisht 690 mijë nxënësve, të cilët përfaqësojnë rreth 29 milionë 15-vjeçarë nga shkollat e 81 shteteve dhe të ekonomive të botës. Në këtë studim morën pjesë 37 vende anëtare të OECD-së dhe 44 shtete dhe ekonomi partnere, përfshirë edhe Kosovën. Nga rajoni i Ballkanit Perëndimor, në PISA 2022 kanë marrë pjesë edhe Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia, ndërsa Bosnja dhe Hercegovina nuk ishte pjesëmarrëse në këtë cikël të vlerësimit.

Mostra për PISA 2022 në Kosovë përfshin 6,027 nxënës të lindur në vitin 2006, të zgjedhur nga 229 shkolla të ndryshme, ku mesatarisht çdo shkollë ka kontribuar me rreth 26.3 nxënës. Shumica e nxënësve të përfshirë në test kanë qenë në klasën e 9-të ose të 10-të, duke përfshirë 98% të tyre, siç detajohet në tabelën 1. Në total, 5,784 nxënës kanë marrë pjesë në testin e matematikës, ndërsa nga ta 3,155 nxënës kanë kryer testet në lexim dhe shkencë. Procesi i testimit në Kosovë është realizuar në periudhën 5-25 maj 2022.

TABELA 1. Nxënësit pjesëmarrës në PISA 2022 sipas klasave⁷

Klasa	Numri i nxënësve	Përqindja
Klasa 7	4	0.1%
Klasa 8	12	0.2%
Klasa 9	1,052	17.5%
Klasa 10	4,849	80.5%
Klasa 11	110	1.8%
Gjithsej	6,027	100.0%

⁷ PISA 2022 Technical Report. Annex C: Student and School Sample Sizes. <https://www.oecd.org/pisa/data/pisa2022technicalreport/PISA-2022-Technical-Report-AnnexC-Student-and-School-Sample-Size.xlsx>

Nxënësit kosovarë kanë shënuar një rezultat mesatar prej 355 pikësh në Matematikë, duke u pozicionuar në vendin e 75-të nga 81 vende pjesëmarrëse; 342 pikë në Lexim, duke zënë vendin e 77-të; dhe 357 pikë në Shkencë, duke u renditur në vendin e 78-të. Në fushën e matematikës, arritjet e nxënësve nga Kosova janë statistikiisht të krahasueshme me ato të nxënësve nga Panamaja (vendi i 74-të) dhe Filipinet (vendi i 76-të). Në fushën e leximit, arritjet e tyre mund të krahasohen me të nxënësve nga Filipinet (vendi i 76-të), Jordania (vendi i 78-të) dhe Maroku (vendi i 79-të), ndërsa në fushën e shkencës janë në një nivel të ngjashëm me nxënësit nga Republika Domenikane (vendi i 77-të), Filipinet (vendi i 79-të) dhe Uzbekistani (vendi i 80-të)⁸.

Përveç vlerësimit me pikë, pjesëmarrësit në testin PISA klasifikohen në një prej “niveleve të aftësive” (proficiency levels), të cilat janë të përcaktuara veçmas për çdo disiplinë të testit. Në tabelën 2 paraqiten 8 nivelet e aftësive për fushën e matematikës, duke treguar numrin minimal të pikëve që nevojiten për t’u klasifikuar në secilin nivel, si dhe përqindjen e nxënësve të testuar në OECD që bëjnë pjesë në çdo nivel. Për shkak të hapësirës dhe natyrës së këtij raporti, nuk po japim përshkrime të detajuara për nivelet e aftësive, por ato mund të gjenden në publikimet zyrtare të OECD⁸. Është e rëndësishme të theksohet se niveli 2 konsiderohet si standardi minimal i arritjeve për nxënësit, prandaj ata që klasifikohen nën këtë nivel konsiderohen si nxënës me performancë të ulët (low performing students). Ndërkaq, nxënësit që klasifikohen në nivelet 5 dhe 6 konsiderohen nxënës me performancë të lartë (high performing students).

TABELA 2. Nivelet e aftësive në PISA 2022 për fushën e matematikës

Niveli	Kufiri i poshtëm i pikëve për t’u klasifikuar në nivelin përkatës	Përqindja e nxënësve nga vendet e OECD të cilët bëjnë pjesë në nivelin përkatës
6	669	2.0%
5	607	6.7%
4	545	23.6%
3	482	45.6%
2	420	68.9%
1a	358	87.6%
1b	295	97.4%
1c	233	99.7%

Tabela 3 jep një pasqyrë të arritjeve të nxënësve kosovarë në tri ciklet e fundit të PISA, si dhe një krahasim me vendet tjera të Rajonit dhe ato të OECD.

⁸ PISA 2022 Results (Volume I)-The State of Learning and Equity in Education. https://www.oecd-ilibrary.org/education/pisa-2022-results-volume-i_53f23881-en

TABELA 3. Pasqyrë e rezultatit në PISA në ciklet 2015-2022

Cikli	Disiplina	Lexim			Matematikë			Shkencë		
		Pikë	Niv<2	Niv. 5&6	Pikë	Niv<2	Niv. 5&6	Pikë	Niv<2	Niv. 5&6
2015	Kosova	347	76.9%		362	77.7%		378	67.7%	
	OECD	493	21%	8.1%	490	23.4%	10.6%	493	21.3%	7.7%
	Shqipëria	405	50.3%	1%	413	53%	1.1%	427	41.7%	0.3%
	Mali i Zi	427	41.9%	1.4%	418	51.9%	1.5%	411	51%	0.5%
	Maqedonia e Veriut	352	70.7%	0.2%	371	70.2%	0.8%	384	62.9%	0.2%
2018	Kosova	353	78.7%		366	77%		365	76.5%	
	OECD	487	22.6%	8.7%	489	24.1%	10.9%	489	22%	6.8%
	Shqipëria	405	52.2%	0.4%	437	42.4%	2.3%	417	47%	0.2%
	Mali i Zi	421	44.4%	0.8%	430	46.2%	1.8%	415	48.2%	0.3%
	Maqedonia e Veriut	393	55.1%	0.3%	394	61%	1.1%	413	49.5%	0.8%
	Serbia	439	37.7%	2.5%	448	39.7%	5.2%	440	38.3%	1.6%
2022	Kosova	342	83%		355	85%		357	79%	
	OECD	476	26%	7%	472	31%	9%	485	24%	7%
	Shqipëria	358	73.7%	0.1%	368	74%	0.7%	376	67.3%	
	Mali i Zi	405	53%	0.6%	406	60%	1%	403	55%	0.3%
	Maqedonia e Veriut	359	74%		389	66%	0.7%	380	65%	
	Serbia	440	36%	2%	440	43%	4%	447	35%	2%

Burimi: PISA Data Explorer

Tabela 3 tregon se **nxënësit kosovarë kanë mbetur prapa në krahasim me mesataren e vendeve të OECD dhe me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor**. Krahasuar me vitin 2018, ata kanë shënuar një rënie në rezultatet e tyre në fushën e leximit dhe të matematikës prej gjithsej 11 pikësh dhe në shkencë prej 8 pikësh. Trend i ngjashëm i rënies është vërejtur edhe në vendet e OECD dhe në vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, me përjashtim të Serbisë, e cila ka shënuar rënie në matematikë, por përmirësim në lexim dhe në shkencë. Në anën tjetër, Shqipëria ka shënuar rënie më të madhe në performancë: 47 pikë në lexim, 69 pikë në matematikë dhe 39 pikë në shkencë.


Në tabelën 3 janë dhënë edhe përqindjet e nxënësve me performancë të ulët sipas disiplinave. Në rastin e Kosovës, këto përqindje janë në rritje që nga viti 2015 dhe në vitin 2022 kanë arritur në nivele shqetësuese - **83% e nxënësve nuk arrijnë standardin minimal në lexim, 85% në matematikë dhe 79% në shkencë**. Me 355 pikë në matematikë, **nxënësi mesatar kosovar klasifikohet në nivelin 1b**, ndërsa nxënësi mesatar i OECD klasifikohet në nivelin 2. Gjithashtu, **në asnjë nga disiplinat dhe në asnjërin nga ciklet e PISA-s në të cilat ka marrë pjesë Kosova, nuk ka nxënës që kanë arritur nivelin 5 ose 6 të aftësive**.

Grafikët 1 dhe 2 ofrojnë një pasqyrë më të qartë të ndryshimeve në performancën e nxënësve kosovarë ndër vite, duke treguar trendët dhe ndryshimet në rezultatet e tyre në krahasim me ciklet e kaluara të PISA-s.

GRAFIKU 1. Performanca e nxënësve kosovarë në PISA sipas disiplinave dhe viteve të testimit



GRAFIKU 2. Nxënësit kosovarë me performancë të ulët në PISA sipas disiplinave dhe viteve të testimit



Grafiku 3 jep një pasqyrë të performancës së nxënësve kosovarë sipas klasave, ku, siç është e pritshme më mirë performojnë nxënësit e klasave të larta.

GRAFIKU 3. Performanca e nxënësve kosovarë në PISA 2022 sipas disiplinave dhe klasave



Dallimi në performancë mes 10% të nxënësve që kanë arritur rezultatet më të larta në matematikë dhe 10% të atyre me rezultatet më të ulëta është i dukshëm dhe statistikisht i rëndësishëm në të gjitha shtetet dhe ekonomitë që marrin pjesë në PISA, pa asnjë përjashtim⁹. Sipas të dhënave nga tabela 4, ky hendek në performancë në Kosovë është qartësisht më i ngushtë në krahasim me mesataren e OECD-së si dhe mesataren e vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor.

TABELA 4. Krahasimi mes të nxënësve me rezultate më të larta dhe më të ulëta në matematikë

Shteti	10% me rezultatet më të larta	10% me rezultatet më të ulëta	Diferenca
Kosova	438	280	159
Shqipëria	481	266	216
Mali i Zi	517	306	211
Maqedonia e Veriut	500	287	213
Serbia	558	329	229
OECD	590	355	235

Në vijim përqendrohemi në performancën e nxënësve në dy dimensione të vlerësimit në matematikë: **proceset** dhe **përmbajtja**. Secila pyetje nga matematika në PISA 2022 u klasifikua në një prej katër kategorive të proceseve matematikore: 1) formulimi; 2) përdorimi; 3) interpretimi dhe 4) rezonimi. Po ashtu, secila pyetje u klasifikua në një prej katër kategorive të përmbajtjes: 1) ndryshimi dhe raportet; 2) sasia; 3) hapësira dhe forma; dhe 4) pasiguria dhe të dhënat.

Proceset



Formulimi: aftësia e nxënësit që t'i njohë konceptet dhe idetë matematike që fshihen pas problemeve të botës reale dhe që t'i strukturojë ato matematikisht.



Përdorimi: aftësia që t'i zbatojë metodat dhe aparaturën matematikore të përshtatshme për të zgjidhur probleme që janë formuluar matematikisht dhe për të arritur në përfundime matematikore.



Interpretimi: aftësia e reflektimit për rezultatet ose përfundimet dhe që t'i interpretojë ato në kontekstin e problemit real që ka nisur procesin.



Rezonimi: aftësia që të përdorë koncepte, mjete dhe logjikë matematike për të konceptuar dhe krijuar zgjidhje për probleme dhe situata të jetës reale, që përfshin njohjen e natyrës matematikore të një problemi dhe zhvillimin e strategjive për zgjidhjen e tij.

Përmbajtja



Ndryshimi dhe raportet: të kuptuarit e llojeve të ndryshimit, përdorimi i modeleve matematikore të përshtatshme për përshkrimin dhe për parashikimin e ndryshimit.



Sasia: sensi për numra dhe vlerësim; kuantifikimi i attributeve, objekteve, raporteve, situatave dhe entiteteve rreth nesh; gjykimi i interpretimeve dhe argumenteve bazuar në sasi.




Hapësira dhe forma: modellet; vetitë e objekteve; vizualizimet hapësinore; pozicionet dhe orientimet; përfaqësimet e objekteve; dekodimi dhe kodimi i informacionit vizual; lëvizja, zhvendosja, etj.



Pasiguria dhe të dhënat: njohja e vendit të variacionit në botën reale, përfshirë sensin për kuantifikimin e atij variacioni; pranimi i pasigurisë dhe gabimit në përfundime; formimi, interpretimi dhe vlerësimi i përfundimeve në situata ku është e pranishme pasiguria.

Në grafikët 4 dhe 5 janë dhënë rezultatet mesatare të nxënësve për të dy dimensionet sipas kategorive dhe shteteve, përfshirë mesataren e OECD. Analiza e rezultateve tregon se në rastin e Kosovës nuk ka dallime domethënëse në mes të performancës së nxënësve në kategori të ndryshme të proceseve edhe pse **interpretimi duket të jetë aspekti më i dobët i zbatimit të proceseve matematikore**, përkundër mesatares së OECD ku nxënësit tregojnë aftësi më të mira në interpretim sesa në kategoritë tjera. Sa i

GRAFIKU 4. Performanca e nxënësve në matematikë sipas kategorive të proceseve



Kosova

352 Formulimi | 357 Përdorimi | 350 Interpretimi | 353 Rezonimi

Shqipëria

376 Formulimi | 367 Përdorimi | 360 Interpretimi | 369 Rezonimi

Mali i Zi

399 Formulimi | 399 Përdorimi | 386 Interpretimi | 403 Rezonimi

Maqedonia e Veriut

385 Formulimi | 387 Përdorimi | 384 Interpretimi | 389 Rezonimi

Serbia


437 Formulimi | 437 Përdorimi | 438 Interpretimi | 440 Rezonimi

OECD

469 Formulimi | 472 Përdorimi | 474 Interpretimi | 473 Rezonimi

përket përmbajtjes, nxënësit kosovarë demonstrojnë performancë më të mirë në pyetje nga kategoria e “hapësirës dhe formave” sesa në pyetje nga kategoria e “ndryshimit dhe raporteve”, ndërsa pika më e dobët del të jenë pyetjet nga kategoria e “pasigurisë dhe të dhënave” ku bëjnë pjesë probabiliteti dhe statistika. Ndërkaq, në vendet e OECD vërehet një performancë më e mirë në kategorinë “pasiguria dhe të dhënat” dhe një performancë më e balancuar përgjatë tri kategorive të tjera të përmbajtjes.

GRAFIKU 5. Performanca e nxënësve në matematikë sipas kategorive të përmbajtjes



Kosova

352	356	357	348
Formulimi	Përdorimi	Interpretimi	Rezonimi

Shqipëria

367	365	376	363
Formulimi	Përdorimi	Interpretimi	Rezonimi

Mali i Zi

396	406	409	402
Formulimi	Përdorimi	Interpretimi	Rezonimi

Maqedonia e Veriut

386	388	384	385
Formulimi	Përdorimi	Interpretimi	Rezonimi

Serbia

439	439	441	435
Formulimi	Përdorimi	Interpretimi	Rezonimi

OECD

470	472	471	474
Formulimi	Përdorimi	Interpretimi	Rezonimi

5. Barazia në arsim


Barazia në arsim është synim kyç dhe vlerë themelore e politikave arsimore. PISA e definon këtë barazi si sigurim i mundësive të barabarta për çdo nxënës që të përfitojë nga arsimi, pa marrë parasysh faktorë si gjinia, sfondi familjar ose socio-ekonomik, ose aftësia e kufizuar. Kjo kuptohet, jo si një uniformitet në trajtimin ose rezultatet e nxënësve, por si mundësi që të adresohen nevojat specifike të secilit, duke pranuar diversitetin e faktorëve që ndikojnë në performancën e tyre edukative. Në kontekstin e Kosovës, përfshirja në arsim ka avancuar shumë në çerekshekullin e fundit, veçanërisht në rritjen e pjesëmarrjes në arsim për vajzat, fëmijët me aftësi të kufizuar dhe ata nga shtresat me status socio-ekonomik më të ulët.

Ky raport do të shqyrtojë rezultatet e nxënësve kosovarë në PISA, duke u fokusuar në ndikimin e gjinisë dhe statusit socio-ekonomik në performancën e tyre.


5.1. Aspektet gjinore

Rezultatet e testit PISA në vendet anëtare të OECD tregojnë se djemtë kanë një performancë më të mirë në matematikë në krahasim me vajzat, performancë të ngjashme ndërmjet djemve dhe vajzave në shkencë, dhe një performancë më të lartë të vajzave në lexim (Grafiku 6). Megjithatë, në vendet e Ballkanit Perëndimor, trendi është pak më ndryshe, ku hendeku mes djemve dhe vajzave shkon duke u ngushtuar, me një trend të dominimit të vajzave në Matematikë. Në Kosovë, në vitin 2015, djemtë mesatarisht arritën 8 pikë më shumë në Matematikë se vajzat, në 2018 kjo diferencë u zvogëlua në 4 pikë, ndërsa në 2022 djemtë dhe vajzat arritën një mesatare të njëjtë prej 355 pikësh. Për më tepër, në fushën e leximit dhe të shkencës, arritjet mesatare të vajzave në Kosovë janë më të larta se sa ato të djemve (Grafiku 7).

GRAFIKU 6. Performanca e nxënësve në vendet e OECD sipas gjinisë dhe viteve të testimit



GRAFIKU 7. Performanca e nxënësve kosovarë sipas gjinisë dhe viteve të testimit



5.2. Statusi socio-ekonomik

Statusi socio-ekonomik është një koncept i gjerë që përmbledh shumë aspekte të ndryshme të një personi. Për shembull, në rastin e një nxënësi, statusi socio-ekonomik mund të përcaktojë mundësinë për qasjen e tij ose të saj në burime edukative si librat dhe teknologjia, cilësinë e ushqimit dhe strehimit, si dhe mundësinë për të marrë pjesë në aktivitete jashtëshkollore që mund të rrisin përvojat dhe njohuritë e nxënësve. Në PISA, statusi socio-ekonomik i një nxënësi matet përmes **indeksit të statusit ekonomik, social dhe kulturor (ESCS)**. ESCS është një pikëzim i përbërë nga informacioni i tre komponentëve: niveli më i lartë i arsimimit të prindërve (indeksi PARED); statusi më i lartë i punësimit të prindërve (indeksi HISEI); dhe pasuritë në shtëpi (indeksi HOMEPOS, i cili është një tregues për pasurinë familjare). Ky informacion për secilin nxënës është mbledhur përmes një pyetësori që nxënësit plotësuan pas testit të PISA-s.

Shkalla e ESCS ka një mesatare prej 0 dhe një devijim standard prej 1 për vendet anëtare të OECD. Nëse ESCS është më i madh se 0, kjo nënkupton se nxënësi vjen nga një sfond socio-ekonomik dhe kulturor që është mbi mesataren e vendeve të OECD, duke pasqyruar kushte socio-ekonomike më të favorshme. Nëse ESCS është më i ulët se 0, kjo tregon se nxënësi vjen nga një sfond socio-ekonomik dhe kulturor që është nën mesataren e vendeve të OECD, gjë e cila pasqyron kushte socio-ekonomike më pak të favorshme.

Tabela 5 ofron të dhëna për statusin socio-ekonomik dhe kulturor të nxënësve nga vendet e Ballkanit Perëndimor në bazë të ESCS dhe lejon krahasimin me mesataren e OECD-së. Në këtë tabelë, nxënësit janë ndarë në katër kategori sipas ESCS, ku në çerekun e parë bëjnë pjesë nxënësit me indeks më të ulët, ndërsa në çerekun e katërt nxënësit me indeks më të lartë. Është e dukshme se mesatarja e ESCS për nxënësit kosovarë është më e ulët se ajo e nxënësve nga vendet e tjera fqinje të Kosovës, me përjashtim të Shqipërisë. Vetëm çereku i tretë i nxënësve nga Kosova arrin nivelin e mesatares së OECD-së. Ndërsa, diferenca mes mesatareve të ESCS të nxënësve kosovarë nga çereku i katërt dhe i pari është më e vogël krahasuar me atë në vendet e OECD-së, që tregon se në Kosovë ka më pak ndarje në statusin socio-ekonomik dhe kulturor midis këtyre dy kategorive të nxënësve. Një rezultat i ngjashëm vërehet edhe kur krahasohet 10% e nxënësve me vlerën më të ulët të ESCS me 10% të nxënësve me vlerën më të lartë të ESCS.

TABELA 5. Statusi socio-ekonomik dhe kulturor sipas ESCS

Shteti	Të gjithë nxënësit	Çereku i parë (1)	Çereku i dytë (2)	Çereku i tretë (3)	Çereku i katërt (4)	(4)-(1)	10% me ESCS më të ulët (A)	10% me ESCS më të lartë (B)	(B)-(A)
Kosova	-0.34	-1.51	-0.61	0.00	0.75	2.26	-1.53	0.78	2.31
Shqipëria	-0.75	-2.15	-1.17	-0.34	0.65	2.81	-2.20	0.69	2.89
Mali i Zi	-0.21	-1.31	-0.50	0.12	0.87	2.18	-1.28	0.89	2.17
Maqedonia e Veriut	-0.28	-1.51	-0.59	0.11	0.87	2.37	-1.51	0.90	2.41
Serbia	-0.20	-1.28	-0.51	0.13	0.86	2.14	-1.25	0.91	2.16
OECD	0.00	-1.22	-0.26	0.41	1.09	2.31	-1.23	1.12	2.34

Tabela 6 ilustron se statusi socio-ekonomik ka ndikim në performancën e nxënësve në testin PISA, por në rastin e Kosovës ky ndikim është më i moderuar krahasuar me vendet e OECD dhe me vendet fqinje. Diferenca në performancë midis nxënësve me status socio-ekonomik të lartë (çereku i katërt) dhe atyre me status socio-ekonomik të ulët (çereku i parë) është vetëm 39 pikë. Gjithashtu, rritja e ESCS me një njësi korrespondon me një rritje prej 17 pikësh në performancë, e cila është më e vogël se në vendet e OECD dhe në vendet fqinje, ndërsa është e barabartë me atë të Shqipërisë. Fakti që **dallimet socio-ekonomike në Kosovë kanë një ndikim më të kufizuar në performancën e nxënësve** dëshmohet edhe nga përqindja më e lartë e nxënësve të qëndrueshëm (17.7%) në krahasim me vendet e tjera. Nxënësit e qëndrueshëm në këtë kontekst janë ata me status socio-ekonomik të ulët që performojnë në nivelin e 25%-shit të nxënësve me rezultatet më të mira në test.

TABELA 6. Performanca në matematikë në varësi nga statusi socio-ekonomik

Shteti	Diferenca në pikët e matematikës e ndërlidhur me rritjen e ESCS për një njësi	Çereku i parë (1)	Çereku i dytë (2)	Çereku i tretë (3)	Çereku i katërt (4)	(4)-(1)	Nxënësit e qëndrueshëm
Kosova	17	342	346	353	381	39	17.7%
Shqipëria	17	353	358	363	402	49	17.1%
Mali i Zi	29	375	396	412	442	67	14.0%
Maqedonia e Veriut	31	356	376	397	431	76	12.3%
Serbia	39	401	429	449	482	81	12.3%
OECD	39	431	462	488	525	93	10.2%

Burimi: PISA 2022 Results (Volume I), Table I.B1.4.3

Një nga faktorët e statusit socio-ekonomik që merret në konsideratë është **kualifikimi më i lartë arsimor i prindërve**, i cili matet sipas niveleve të ISCED⁹ nga 1 deri në 8. Në kontekstin e Kosovës dhe të vendeve tjera të Ballkanit Perëndimor, këto nivele përfshijnë: arsimin fillor (ISCED 1), arsimin e mesëm të ulët (ISCED 2), arsimin e mesëm të lartë në formatet e tij të ndryshme (ISCED 3), arsimin postsekondar jo-terciar (ISCED 4), arsimin e lartë profesional (ISCED 5), nivelin baçelor (ISCED 6), nivelin master (ISCED 7) dhe nivelin e doktoratës (ISCED 8). Në vendet e OECD, performanca e nxënësve në matematikë rritet ndjeshëm në varësi të kualifikimit arsimor të prindërve nga ISCED 1 në 7, por vërehet një rënie e papritur në nivelin 8. Në Kosovë dhe vendet fqinje, kjo tendencë nuk është aq e qartë, megjithatë në përgjithësi nxënësit me të paktën një prind të kualifikuar në nivelin baçelor ose master tregojnë performancë më të mirë, me një rënie të dukshme në nivelin e doktoratës. (Tabela 7)

⁹ ISCED - Standardi Ndërkombëtar për Klasifikimin e të Dhënave të Arsimit i përcaktuar nga UNESCO në vitin 1997 me ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme

TABELA 7. Performanca në matematikë sipas kualifikimit më të lartë arsimor të prindërve

†	Kualifikimi më i lartë arsimor i prindërve sipas ISCED									
	<1	1	2	3.3	3.4	4	5	6	7	8
Kosova		324	351	358	358	†	353	386	363	344
Shqipëria	†	344	360	358	374	†	362	393	398	349
Mali i Zi	†	348	346	368	409	392	396	425	427	397
Maqedonia e Veriut	†	338	335	396	376	376	374	407	415	381
Serbia	†	†	358	394	442	432	433	464	463	442
OECD	397	406	420	444	461	462	470	494	506	473

† - nuk janë plotësuar standardet e raportimit

Burimi: PISA Data Explorer

Tabela 8 ilustron shpërndarjen e kualifikimeve më të larta arsimore të prindërve sipas niveleve të ISCED. Në Kosovë, 68.5% e nxënësve kanë raportuar se të paktën njëri prind ka një kualifikim të lartë arsimor (nivele ISCED 5-8), krahasuar me 68% në vendet e OECD, 50.2% në Shqipëri, 66.2% në Maqedoninë e Veriut, 69.9% në Malin e Zi dhe 62.9% në Serbi. Veçanërisht vlen të theksohet se **Kosova ka përqindjen më të lartë të nxënësve që raportojnë se të paktën njëri prind ka kualifikim të nivelit të doktoratës – 20.1%**, duke tejkaluar mesataren e OECD prej 11.9%, si dhe përqindjet e të gjitha vendeve fqinje.

TABELA 8. Kualifikimi më i lartë arsimor i prindërve sipas ISCED













Shteti	Kualifikimi më i lartë arsimor i prindërve sipas ISCED										Gjithsej
	<1	1	2	3.3	3.4	4	5	6	7	8	
Kosova	11	113	381	256	1081	0	1455	352	1016	1174	5839
	0.2%	1.9%	6.5%	4.4%	18.5%	0.0%	24.9%	6.0%	17.4%	20.1%	100.0%
Shqipëria	21	258	1067	261	1168	0	918	187	974	723	5577
	0.4%	4.6%	19.1%	4.7%	20.9%	0.0%	16.5%	3.4%	17.5%	13.0%	100.0%
Maqedonia e Veriut	19	65	395	646	593	442	520	1771	970	976	6397
	0.3%	1.0%	6.2%	10.1%	9.3%	6.9%	8.1%	27.7%	15.2%	15.3%	100.0%
Mali i Zi	7	31	145	257	912	366	1074	1490	664	754	5700
	0.1%	0.5%	2.5%	4.5%	16.0%	6.4%	18.8%	26.1%	11.6%	13.2%	100.0%
Serbia	3	9	144	396	1305	496	1307	1302	696	677	6335
	0.0%	0.1%	2.3%	6.3%	20.6%	7.8%	20.6%	20.6%	11.0%	10.7%	100.0%
OECD	1605	3901	14287	15987	34557	17622	32033	58278	63715	32636	274621
	0.6%	1.4%	5.2%	5.8%	12.6%	6.4%	11.7%	21.2%	23.2%	11.9%	100.0%

Burimi: PISA Data Explorer; PISA 2022 SPSS Data Files- <https://www.oecd.org/pisa/data/2022database/>

Një aspekt tjetër i rëndësishëm i statusit socio-ekonomik është **posedimi i sendeve nga nxënësit në shtëpitë e tyre**. Në këtë kontekst, **kemi zgjedhur të fokusohemi në posedimin e kompjuterit**, duke pasur parasysh rëndësinë e tij si mjet në mbështetje të të mësuarit (Tabela 9). Në Kosovë, kur nxënësit u pyetën nëse disponojnë një kompjuter (desktop, laptop ose tablet) në shtëpi për përdorim në punët shkollore, 83.8% e nxënësve u përgjigjën pozitivisht, ndërsa 16.2% thanë se nuk kanë². Dallimi në performancën në testin e matematikës të PISA mes nxënësve që kanë dhe atyre që nuk kanë kompjuter në shtëpi është relativisht i vogël, vetëm 13 pikë. Ky dallim është më i theksuar në vendet e OECD, ku një shumicë më e madhe prej 92.9% të nxënësve posedon një kompjuter dhe ku dallimi në performancë arrin në 61 pikë.

Në vendet tjera të Ballkanit Perëndimor, dallimet janë gjithashtu më të mëdha: në Shqipëri, ku 75.6% e nxënësve raportojnë se kanë kompjuter, dallimi në performancë është 26 pikë; në Maqedoninë e Veriut, ku 89.8% kanë kompjuter, dallimi është 56 pikë; në Malin e Zi, ku 86.4% kanë kompjuter, dallimi është 38 pikë; dhe në Serbi, ku një përqindje e lartë prej 94.3% të nxënësve posedojnë kompjuter, dallimi në performancë arrin në 70 pikë. Këto të dhëna tregojnë se në Kosovë, pavarësisht një përqindjeje të lartë të nxënësve që kanë qasje në teknologji, ndikimi i kësaj qasjeje në performancën akademike, të paktën në matematikë, është më i vogël krahasuar me vendet e tjera të rajonit dhe të OECD-së.

TABELA 9. Performanca në matematikë sipas posedimit të kompjuterit në shtëpi që mund të përdoret për punë shkollore

Shteti	Posedojnë kompjuter		Nuk posedojnë kompjuter	
	Mesatarje në matematikë	Përqindja e nxënësve	Mesatarje në matematikë	Përqindja e nxënësve
Kosova	360	 83.8%	347	 16.2%
Shqipëria	379	 75.6%	353	 24.4%
Mali i Zi	413	 86.4%	375	 13.6%
Maqedonia e Veriut	399	 89.8%	343	 10.2%
Serbia	445	 94.3%	375	 5.7%
OECD	480	 92.9%	419	 7.1%


Burimi: PISA Data Explorer; PISA 2022 SPSS Data Files

5.3. Pjesëmarrja në edukimin parashkollor

Kohëzgjatja e edukimit parashkollor është një tregues kyç i barazisë në arsim, veçanërisht në Kosovë ku pjesëmarrja në edukimin parashkollor vazhdon të jetë e ulët, si rezultat i mundësive të kufizuara ekonomike dhe i rrjetit të institucioneve, i cili kryesisht shtrihet në zonat urbane.

Sipas Grafikut 8, nuk duket të ekzistojë një korrelacion i drejtpërdrejtë midis kohëzgjatjes së edukimit parashkollor dhe performancës në testin e matematikës të PISA. Megjithatë, studime të shumta kanë treguar se pjesëmarrja në arsimin parashkollor ka një ndikim të rëndësishëm në performancën e mëvonshme të nxënësve në arsim.^{10 11}

GRAFIKU 8. Performanca në testin e matematikës sipas kohëzgjatjes së edukimit parashkollor



Burimi: PISA Data Explorer

10 Barnett S.: Long-term effects of early childhood programs on cognitive and school outcomes, The Future of Children (1995). <https://doi.org/10.2307/1602366>

11 Berlinski S. et al: The effect of pre-primary education on primary school performance. Journal of Public Economics Volume 93, Issues 1-2, February 2009, Pages 219-234. <https://doi.org/10.1016/j.jpubeco.2008.09.002>

5.4. Tipi dhe lokacioni i shkollës

Në testin PISA të mbajtur në Kosovë, 94.3% e nxënësve vinin nga shkollat publike, ndërsa 5.7% e tyre nga shkollat private. Në krahasimin e performancës në testin e matematikës, shkollat private tregojnë një avantazh të konsiderueshëm ndaj shkollave publike në vendet e OECD (42 pikë), si dhe në Kosovë (34 pikë), në Shqipëri (62 pikë) dhe në Maqedoni të Veriut (65 pikë). Në kundërshtim, në Serbi shkollat private kanë një disavantazh në krahasim me ato publike (-21 pikë). Sidoqoftë, siç ilustron në tabelën 10, pasi të bëhet normalizimi i rezultateve duke u bazuar në indeksin e statusit socio-ekonomik dhe kulturor (ESCS), shkollat publike dalin të kenë avantazh në vendet e OECD dhe ato të rajonit, përveç në Shqipëri ku avantazhi mbetet në favor të shkollave private.

TABELA 10. Dallimi në performancë në fushën e matematikës sipas tipit të shkollës

Shteti	Diferenca para normalizimit të rezultatit sipas ESCS	Diferenca pas normalizimit të rezultatit sipas ESCS
Kosova	34	-10
Shqipëria	62	30
Maqedonia e Veriut	65	-15
Serbia	-21	-39
OECD	42	-17

Burimi: PISA 2022 Results (Volume II), Table II.B1.6.21

Shkollat në studimin PISA janë klasifikuar në katër grupe të ndryshme bazuar në numrin e banorëve në zonën ku ndodhet shkolla: 1) Zona rurale me më pak se 3,000 banorë; 2) Qyteza, me popullsi nga 3,000 deri rreth 15,000 banorë; 3) Qytete mesatare me popullsi nga 15,000 deri në rreth 100,000 banorë; dhe 4) Qytete të mëdha me popullsi nga 100,000 deri në rreth 1 milion banorë. Nga 229 drejtorët e shkollave kosovare të përfshira në PISA, 203 janë përgjigjur në pyetjen lidhur me komunitetin e shkollës, duke përfaqësuar 5,345 nxënës pjesëmarrës në testin PISA. Sipas përgjigjeve të tyre, rezultoni se 73 shkolla janë në zona rurale, 19 në qyteza, 73 në qytete dhe 38 shkolla në qytete të mëdha.²

Tabela 11 ofron një pasqyrë të performancës së nxënësve në testin e matematikës në varësi të vendndodhjes gjeografike të shkollës. Është e dukshme një diferencë e konsiderueshme në rezultatet mes shkollave rurale dhe atyre urbane, jo vetëm në vendet e Ballkanit Perëndimor, por edhe në vendet anëtare të OECD-së.

TABELA 11. Performanca në testin e matematikës sipas lokacionit të shkollës

Shteti	Rurale	Qytezë	Qytet mesatar	Qytet i madh
Kosova	337	352	356	365
Shqipëria	351	355	370	383
Mali i Zi	✚	401	402	414
Maqedonia e Veriut	341	390	387	393
Serbia	343	389	430	452
OECD	451	460	469	483

✚ - nuk janë plotësuar standardet e raportimit

Burimi: PISA Data Explorer

Klasat më të vogla zakonisht konsiderohen si një mundësi që u lejon mësimdhënësve të përqendrohen më thellësisht në nevojat specifike të çdo nxënësi individualisht, duke ulur në të njëjtën kohë edhe nevojën për menaxhimin e pengesave gjatë orëve mësimore. Kjo praktikë ndihmon në krijimin e një mjedisi mësimor më të përshtatshëm dhe më të qetë për nxënësit, duke e bërë procesin e mëimit më efektiv dhe të fokusuar. Përveç kësaj, mësimdhënësit gjejnë kushte më të mira pune në klasa ku numri i nxënësve është më i ulët, pasi kjo u mundëson atyre të zhvillojnë një marrëdhënie më të afërt dhe më të thellë me secilin nxënësi. Pavarësisht nga pritshmëria pozitive që lidhet me klasat më të vogla, të dhënat nga PISA nuk tregojnë gjithmonë një korrelacion të drejtpërdrejtë mes madhësisë së klasës dhe performancës së lartë të nxënësve.

Tabela 12 paraqet të dhëna mbi performancën e nxënësve në matematikë në varësi të numrit mesatar të nxënësve në klasë, siç është raportuar nga drejtorët e shkollave. Në Kosovë, drejtorët e 192 nga 229 shkollat e zgjedhura kanë dhënë përgjigje për këtë pyetje, që përfaqësojnë 4,956 nga 6,027 nxënësit që kanë marrë pjesë në testin PISA, ose 82.2% e tyre. Nga këta nxënës, 6.6% janë në shkolla ku mesatarja e nxënësve në klasë është nën 15; 27% në shkolla me klasa mesatare prej 16-20 dhe 21-25 nxënës; 23.5% në shkolla me klasa mesatare prej 26-30 nxënës; 11.6% në shkolla me klasa mesatare prej 31-35 nxënës; dhe 3% janë në klasa me më shumë se 36 nxënës.²

Sipas të dhënave të paraqitura në tabelën 12, shkollat në Kosovë me rezultatin më të mirë në testin e matematikës janë ato ku numri mesatar i nxënësve në klasë është midis 31-35, nëse përjashtohet një shkollë e vetme ku drejtori ka raportuar se nxënësit mësojnë në klasa prej 36-40 nxënës. Kjo tendencë ndiqet edhe në vendet e OECD dhe shumicën e vendeve fqinje të Kosovës, përveç Malit të Zi, ku performanca më e lartë vërehet në shkollat me një numër mesatar të nxënësve në klasa midis 26-30. Në Kosovë, nga 15 shkollat ku numri mesatar i nxënësve është 31-35, 12 janë në zona urbane dhe 3 janë në zona rurale ose qyteza me më pak se 15,000 banorë.

TABELA 12. Performanca në testin e matematikës sipas madhësisë mesatare të klasave

Shteti	<15	16-20	21-25	26-30	31-35	36-40	41-45	46-50	>50
Kosova	340	347	346	354	383	391	‡	353	349
Shqipëria	379	361	362	372	374	370	355	341	360
Mali i Zi	386	393	391	423	396	‡	‡	‡	‡
Maqedonia e Veriut	387	385	398	384	425	‡	‡	‡	356
Serbia	‡	412	428	442	507	‡	‡	‡	436
OECD	434	450	466	485	500	457	452	444	471

‡ - nuk janë plotësuar standardet e raportimit

Burimi: PISA Data Explorer

6. Qëndrimet e nxënësve, mësimdhënia dhe të nxënësve

Ky kapitull trajton një aspekt thelbësor të përvojës shkollore të nxënësve - qëndrimet e tyre ndaj mësim-it, mësimdhënies dhe të nxënësve, me një fokus të veçantë në sfidat dhe ndikimin e ankthit nga matematika. Këtu zbulohet se si ndjenjat e frikës dhe shqetësimit që shfaqen në përballjen me detyrat matematikore jo vetëm që pengojnë performancën e nxënësve në testet e matematikës, por edhe ndikojnë thellësisht në mënyrën se si ata angazhohen me procesin e mësimin të matematikës. Përmes një vargu deklaratash specifike, nxënësit janë pyetur për përvojat e tyre të drejtpërdrejta, duke ofruar një pasqyrë të qartë të nivelit të ankthit që ata përjetojnë dhe të ndikimit të tij në arritjet e tyre akademike.

Më tej, ky kapitull trajton gjithashtu rëndësinë e mësimdhënies dhe qasjes që mësimdhënësit ndjekin në orët e matematikës, si dhe vetëbesimin e nxënësve në zgjidhjen e problemeve bazike matematikore. Analiza e të dhënave nga testi PISA 2022 hedh dritë mbi mënyrën se si qëndrimet e nxënësve ndaj matematikës, si dhe ndërveprimet e tyre me mësimdhënësit dhe detyrat e shtëpisë, ndikojnë në performancën e tyre. Këto gjetje theksojnë rëndësinë e krijuarit të një mjedisi mbështetës që nxit mendimin kritik dhe aplikimin praktik të matematikës, duke përgatitur rrugën për arritje më të larta dhe një thellim të njohurive matematikore.

6.1. Ankthi nga matematika

Ankthi nga matematika është një ndjenjë e shqetësimit dhe frikës që shfaqet kur individët përballen me sfida të ndryshme matematikore. Ky ankth jo vetëm që pengon performancën e nxënësve në testet e matematikës, por gjithashtu ndikon negativisht në mënyrën se si ata perceptojnë dhe marrin pjesë në procesin e mësimin të matematikës.

Pyetësi për nxënës përmban në vete një varg deklaratash lidhur me të mësuarit e matematikës, në të cilat nxënësit duhet të japin njëpërgjigje: “nuk jam aspak dakord”, “nuk jam dakord”, “dakord” ose “plotësisht dakord”. Këto deklarata janë: “Shpesh më shqetëson se do të kem vështirësi në orët e matematikës”; “Unë tensionohem së tepërmi kur më duhet të bëj detyrat e shtëpisë së matem-

atikës “; “ Unë bëhem shumë nervoz/e kur zgjidh problema matematike”; “ Unë ndihem i paaftë kur zgjidh një problem matematikor “; “ Kam merak se do të marr nota të këqija në matematikë “; dhe “ Unë ndihem i shqetësuar se mund të mbes në matematikë “ .¹²

Nga përgjigjet e nxënësve është ndërtuar i ashtuquajtur i indeksit nga matematika (ANXMAT), brenda të cilit kalkulohej edhe disa faktorë socio-ekonomikë si: gjinia, mosha e imigrimit (vetëm për nxënësit që kanë lindur në vende të tjera) dhe pasiguria në ushqim. Indeksi paraqet një vlerë numerike, e cila mund të jetë negative ose pozitive, ku vlera më e madhe tregon një shkallë më të lartë të ankthit.

Nga tabela 13 shihet se indeksi i ankthit nga matematika për Kosovë është më i madh se sa mesatarja e OECD dhe indekset e vendeve fqinje. Në pyetësin për nxënës është përfshirë edhe deklarata “Inteligjenca është diçka e juaja, që ju nuk mund ta ndryshoni shumë”, e cila ka për qëllim të sjellë një gjykim për mendësinë e nxënësit në raport me zhvillimin personal. Nxënësit të cilët i janë përgjigjur kësaj deklarate me “plotësisht dakord” ose “dakord” janë përfshirë në kategorinë “Mendësia statike”, ndërsa ata që janë përgjigjur me “nuk jam aspak dakord” ose “nuk jam dakord”, janë klasifikuar në kategorinë e quajtur “Mendësia e zhvillimit”. Nga tabela 13 vërehet se afërsisht 2 nga 3 nxënës kosovarë i takojnë kategorisë “Mendësia statike” për dallim nga 2 nga 5 në vendet e OECD. Po ashtu, vërehet se nxënësit e kësaj kategorie kanë një indeks më të lartë ankthi nga matematika në raport me nxënësit e kategorisë “mendësia e zhvillimit”.

TABELA 13. Indeksi i ankthit nga matematika dhe kategoritë e “mendësisë”

Shteti	Indeksi i ankthit nga matematika (ANXMAT)	“Inteligjenca është diçka e juaja, që ju nuk mund ta ndryshoni shumë”		Indeksi i ankthit nga matematika varësisht nga përgjigja në pyetjen “Inteligjenca është diçka e juaja, që ju nuk mund ta ndryshoni shumë”		
		Mendësia statike	Mendësia e zhvillimit	Mendësia statike (1)	Mendësia e zhvillimit (2)	Diferenca (2)-(1)
Kosova	0.26	66.1%	33.9%	0.26	0.23	-0.04
Shqipëria	0.01	69.3%	30.7%	-0.02	0.05	0.06
Mali i Zi	0.16	52.5%	47.5%	0.15	0.16	0.00
Maqedonia e Veriut	0.17	60.0%	40.0%	0.17	0.14	-0.03
Serbia	0.20	48.7%	51.3%	0.23	0.17	-0.06
OECD	0.17	42.2%	57.8%	0.25	0.11	-0.13

Burimi: PISA 2022 Results (Volume I), Table I.B1.2.16

Ankthi në matematikë ndikon negativisht në arritjet e nxënësve në matematikë në çdo sistem arsimor që mori pjesë në PISA 2022, pavarësisht nga karakteristikat e nxënësve dhe të shkollave. Nga tabela 14 shihet se, pas normalizimit për statusin socio-ekonomik dhe kulturor, një pikë rritje e indeksit ANXMAT ndikon në rënie të rezulttit për 12 pikë, ndërkohë që në vendet e OECD për 18 pikë. Po ashtu, për 18 pikë më

¹² Pyetësorët e PISA 2022 për nxënës, drejtorë dhe prindër – versioni për Kosovën. <https://www.oecd.org/pisa/data/2022data-base/Kosovo.zip>

mirë në vendet e OECD performojnë nxënësit që i takojnë kategorisë “Mendësia e zhvillimit” në raport me ata nga kategoria “Mendësia statike”. Në Kosovë kjo diferencë në mes të dy kategorive është relativisht më e vogël – 3 pikë, ndërsa në rastin e Shqipërisë është thuaja jo-ekzistente.

TABELA 14. Performanca në matematikë varësisht nga ankthi dhe mendësia

Shteti	Mesatarja e pikëve në Matematikë	Ndryshimi në performancë në testin e matematikës për nxënësit e kategorisë ‘Mendësi e zhvillimit’		Ndryshimi në performancë në testin e matematikës për një pikë rritje të indeksit të ankthit nga matematika (ANXMAT)	
		Para normalizimit sipas ESCS	Pas normalizimit sipas ESCS	Para normalizimit sipas ESCS	Pas normalizimit sipas ESCS
Kosova	355	4	3	-13	-12
Shqipëria	368	2	0	-17	-15
Mali i Zi	406	6	3	-17	-15
Maqedonia e Veriut	389	19	14	-12	-10
Serbia	440	12	5	-15	-12
OECD	472	24	18	-20	-18

Burimi: PISA 2022 Results (Volume I), Table I.B1.2.17

Sa për ilustrim, po i japim të përmbledhura në tabelën 15 pikët mesatare të nxënësve kosovarë sipas përgjigjeve të tyre në dy nga pyetjet e kategorisë së ankthit nga matematika. Është interesante se 2 në 3 nxënës pajtohen se tensionohen së tepërmi kur duhet t’i bëjnë detyrat nga matematika, ndërsaq 42% e ndiejnë veten të paaftë që të zgjidhin një problem matematikor.

TABELA 15. Performanca në matematikë varësisht nga përgjigjet në deklaratat specifike rreth ndjenjës së ankthit

Deklarata	Pajtohet plotësisht	Pajtohem	Nuk pajtohem	Nuk pajtohem aspak
Unë tensionohem së tepërmi kur më duhet të bëj detyrat e shtëpisë së matematikës	349	363	379	367
	26.7%	41.8%	20.2%	11.3%
Unë ndihem i paaftë kur zgjidh një problem matematikor	344	350	370	383
	13.4%	28.6%	36.8%	17.8%

Burimi: PISA 2022 SPSS Data Files

6.2. Çfarë dinë nxënësit nga matematika?

Në pyetëtorin për nxënësit të PISA-s, një grup prej 10 pyetjesh merret me analizën e vetëbesimit të nxënësve për zgjidhjen e problemeve bazike matematikore. Rreth 2,500 nxënës, që përbëjnë më pak se gjysmën e atyre që kanë marrë pjesë në test, u janë përgjigjur këtyre pyetjeve. Tabela 16 sjell një pasqyrë të performancës së nxënësve në testin e matematikës në lidhje me përgjigjet e tyre në 6 nga këto 10 pyetje, duke përfshirë edhe shpërndarjen e përgjigjeve të nxënësve për çdo pyetje të veçantë.

TABELA 16. Performanca e nxënësve në matematikë varësisht nga vetëbesimi për zgjidhjen e problemeve bazike matematikore

Sa të sigurt ndiheni kur ju duhet të bëni detyrat e mëposhtme të matematikës?	Aspak i/e sigurt	Jo shumë i/e sigurt	I/E sigurt	Shumë i/e sigurt
1. Zgjidhja e një ekuacioni si $3x+5=17$	337	347	362	390
	13.8%	23.8%	35.1%	27.2%
2. Të zgjidhni një ekuacioni si $6x+5 = 29$	335	357	370	392
	14.9%	28.8%	36.8%	19.4%
3. Zgjidhja e një ekuacioni si $2(x+3) = (x+3)(x-3)$	339	351	364	394
	15.1%	27.8%	36.9%	20.3%
4. Llogaritja se sa më i kushtueshëm do të ishte një kompjuter pas shtimit të taksës	340	361	373	385
	20.4%	35.5%	34.0%	10.0%
5. Llogaritja e konsumit të energjisë në javë, për një pajisje elektronike	337	355	370	392
	16.0%	35.2%	34.0%	14.7%
6. Gjetja e distancës aktuale midis dy vendeve në një hartë në shkallën 1:10 000	347	361	364	384
	18.6%	35.4%	33.5%	12.5%

Burimi: PISA Data Explorer; PISA 2022 SPSS Data Files

Sipas të dhënave të paraqitura në tabelën 16, një lidhje e qartë shfaqet midis përgjigjeve të nxënësve dhe performancës së tyre në testin e matematikës, ku nxënësit me më shumë vetëbesim në zgjidhjen e problemeve matematikore kanë tendencë të kenë performancë më të mirë në krahasim me ata që kanë më pak vetëbesim. Pyetjet nga 1 deri në 3 kanë të bëjnë me zgjidhjen e ekuacioneve lineare dhe kuadratike, të cilat nuk janë direkt të lidhura me aplikimin e matematikës në jetën e përditshme. Megjithatë, 37.6% e nxënësve shprehin mungesë të vetëbesimit për zgjidhjen e një ekuacioni elementar me një të panjohur (pyetja 1), ndërsa 43.5% dhe 42.9% nuk janë të sigurt në zgjidhjen e ekuacioneve kuadratike si në pyetjet 2 dhe 3. Vetëbesimi vazhdon të ulet edhe më shumë kur pyetjet lidhen me zbatimin e matematikës në situata të përditshme: 55.9% e nxënësve nuk besojnë se mund të llogarisin çmimin e shitjes së një produkti duke përfshirë taksën (pyetja 4), 51.2% nuk ndihen të aftë të llogarisin konsumin javor të energjisë

për një pajisje elektronike, dhe 54% mendojnë se do të hasin vështirësi për të përcaktuar distancën në hartë kur dihet shkalla e zvogëlimit.

Ky konstatim tregon se një përqindje e konsiderueshme e nxënësve ka mangësi në njohuritë bazike matematikore dhe se aftësia e tyre që këto njohuri t'i zbatojnë në zgjidhjen e problemeve praktike të jetës së përditshme është edhe më e kufizuar.

Një grup tjetër prej 10 pyetjesh në pyetësorin PISA ka synuar të vlerësojë njohjen e koncepteve matematikore nga nxënësit. Këtyre pyetjeve u janë përgjigjur rreth 30% e nxënësve që kanë marrë pjesë në test. Ashtu si në rastin e mëparshëm, një lidhje e qartë shfaqet midis njohjes së koncepteve matematikore dhe rezultateve në testin e matematikës, sipas të dhënave të paraqitura në Tabela 17.

TABELA 17. Performanca e nxënësve në matematikë varësisht nga njohja e koncepteve matematikore

Nëse mendoni për konceptet matematikore: sa familjar jeni me termat e mëposhtëm?	S'kam dëgjuar kurrë për këtë	Kam dëgjuar një ose dy herë	Kam dëgjuar disa herë për këtë	Kam dëgjuar shpeshherë për këtë	E njoh mirë, e kuptoj konceptin
Pjesëtuesi	327 15.4%	339 11.8%	349 13.7%	359 15.8%	382 43.2%
Sipërfaqja e një rrethi	339 13.1%	336 15.0%	358 18.8%	365 22.6%	390 30.5%
Figurat kongruente	346 18.1%	353 19.9%	360 22.9%	366 20.3%	379 18.7%
Teorema e Pitagorës	324 7.1%	334 12.3%	345 19.1%	356 24.7%	387 36.7%
Funksioni eksponencial	367 21.6%	359 20.9%	362 22.8%	367 20.1%	378 14.6%
Probabiliteti	336 10.3%	341 12.4%	348 20.6%	361 24.9%	389 31.8%

Burimi: PISA Data Explorer; PISA 2022 SPSS Data Files

Nxënësit kosovarë kanë një njohje më të kufizuar të koncepteve matematikore krahasuar me bashkëmoshatarët e tyre nga vendet fqinje. Për shembull, ndërsa 43.2% e nxënësve kosovarë raportojnë se kanë njohuri të mira dhe kuptojnë konceptin e pjesëtuesit, në vendet fqinje kjo përqindje varion nga 50.1% në Maqedoninë e Veriut deri në 65.2% në Serbi. Gjithashtu, një mungesë e njohurive vërehet edhe në konceptin e sipërfaqes së rrethit: vetëm 30.3% e nxënësve kosovarë deklarojnë se e njohin dhe e

kuptojnë këtë koncept, krahasuar me 43.9% në Shqipëri, 39.5% në Maqedoninë e Veriut, 43.2% në Malin e Zi dhe 46.2% në Serbi. Të gjitha këto koncepte figurojnë në programin e matematikës për arsimin fillor dhe të mesëm të ulët.

6.3. Mësimdhënia dhe të nxënit

Në pyetësorin për nxënës, një grup prej 20 pyetjesh synon të vlerësojë qasjen e mësimdhënësit në orët e matematikës duke u përqendruar nëse ai/a jo inkurajon mendimin kritik dhe aplikimin praktik të matematikës. Nga ky grup, përgjigjet e nxënësve në 5 pyetje specifike janë paraqitur në tabelën 18. Këto përgjigje janë kategorizuar në pesë grupe të ndryshme, dhe për çdo grup janë treguar pikët e arritura nga nxënësit në testin e matematikës. Rreth 40% e nxënësve që kanë marrë pjesë në testin PISA janë përgjigjur në këto pyetje.

TABELA 18. Performanca e nxënësve në testin e matematikës varësisht nga qasja e mësimdhënësit

Gjatë këtij viti shkollor, sa shpesh i ka bërë mësuesi juaj gjërat e mëposhtme në orët e matematikës?	Asnjëherë ose pothuajse kurrë	Në më pak se gjysmën e orëve të mësimit	Në rreth gjysmën e orëve të mësimit	Në më shumë se gjysmën e orëve të mësimit	Në çdo orë, ose pothuajse çdo orë mësimi
Mësuesi na kërkoi të mbronim përgjigjen tonë për një problem matematikor	350 13.8%	356 20.1%	364 26.2%	370 21.8%	377 18.0%
Mësuesi na kërkoi t'i shpjegonim se si e kemi zgjidhur një problem matematikor	335 16.1%	349 18.0%	365 22.8%	377 19.4%	378 23.7%
Mësuesi na kërkoi t'i shpjegonim se çfarë hamendësimi po bënim teksa zgjidhnim një problem matematikor	344 15.5%	350 20.4%	364 26.4%	375 19.8%	377 17.9%
Mësuesi na kërkoi të mendonim se si lidheshin temat e reja dhe të vjetra të matematikës	352 16.7%	360 20.0%	363 27.3%	372 20.6%	362 15.4%
Mësuesi na tregoi sesi matematika mund të jetë e dobishme në jetën tonë të përditshme	348 15.4%	361 20.0%	368 22.6%	369 19.3%	360 22.7%

Burimi: PISA Data Explorer; PISA 2022 SPSS Data Files

Rezultatet tregojnë një lidhje të qartë midis frekuencës së aktiviteteve të mësimdhënies që inkurajojnë mendimin kritik e aplikimin praktik dhe performancën e nxënësve në testin PISA. Kur mësimdhënësit inkurajojnë nxënësit të mbrojnë përgjigjet e tyre për një problem matematikor, performanca e nxënësve duket se përmirësohet në mënyrë të qëndrueshme. Nxënësit që raportojnë se mësimdhënësi i tyre bën këtë “në çdo orë ose pothuajse çdo orë mësimi” kanë rezultate më të larta në krahasim me ata që thonë se mësimdhënësi bën këtë “asnjëherë ose pothuajse kurrë”.

Një korrelacion i ngjashëm shihet edhe kur mësimitdhënësit i kërkojnë nxënësve të shpjegojnë se si kanë zgjidhur një problem matematikor. Kjo tregon se nxënësit përfitojnë nga të qenit aktivë dhe reflektues në procesin e zgjidhjes së problemeve. Pyetjet që lidhen me hamendësim gjatë zgjidhjes së problemeve matematikore dhe lidhjen e temave të reja me të vjetrat tregojnë gjithashtu një rritje në performancë me rritjen e frekuencës së këtyre aktiviteteve. Interesant është se, kur mësimitdhënësit tregojnë se si matematika mund të jetë e dobishme në jetën e përditshme, nuk shihet një rritje e qartë e performancës së nxënësve me rritjen e frekuencës së këtij aktiviteti.

Në pyetëtorin për nxënësit të PISA-s, një grup prej katër pyetjesh synon të zbulojë se sa kohë mesatarisht nxënësit i dedikojnë detyrave të shtëpisë në disiplinat kryesore që mbulon ky test - Matematikë, Lexim dhe Shkencë - dhe gjithashtu kohën totale që ata i kushtojnë detyrave për të gjitha lëndët. Edhe pse detyrat e shtëpisë për leximin dhe shkencën në kontekstin e Kosovës zakonisht janë të ndara në disa lëndë të ndryshme, në matematikë kjo është më e qartë. Prandaj, në tabelën 19 do të prezantojmë performancën e nxënësve në testin PISA në lidhje me kohën që ata i kushtojnë detyrave të shtëpisë në mënyrë specifike në matematikë dhe në total për të gjitha lëndët.

TABELA 19. Performanca e nxënësve në matematikë varësisht nga koha e shpenzuar për detyra të shtëpisë

Në një javë të zakonshme shkolle, përafërsisht sa kohë shpenzoni për detyrat e shtëpisë në lëndët vijuese?	Deri në 30 minuta në ditë	Më shumë se 30 minuta dhe deri në 1 orë në ditë	Më shumë se 1 orë dhe deri në 2 orë në ditë	Më shumë se 2 orë dhe deri në 3 orë në ditë	Më shumë se 3 orë dhe deri në 4 orë në ditë	Më shumë se 4 orë në ditë
	Detyrat e matematikës	350 46.3%	368 27.5%	375 15.0%	367 5.2%	351 2.0%
Të gjitha lëndët	342 20.7%	354 12.8%	373 19.4%	372 20.5%	370 13.0%	349 13.6%

Burimi: PISA Data Explorer; PISA 2022 SPSS Data Files

Nëse shikojmë performancën e nxënësve në matematikë në varësi të kohës së raportuar për detyrat e shtëpisë në këtë lëndë, vërejmë se performanca arrin kulmin e saj kur nxënësit shpenzojnë «më shumë se 1 orë dhe deri në 2 orë në ditë», pas së cilës fillon të bjerë. Nga ana tjetër, kur shikojmë performancën në lidhje me kohën e kushtuar për detyrat e shtëpisë në të gjitha lëndët, vërejmë se performanca përmirësohet deri në një pikë - “më shumë se 1 orë dhe deri në 2 orë në ditë” - dhe pastaj mbetet relativisht konstante për 2-3 dhe 3-4 orë në ditë, duke shënuar një rënie të madhe për më shumë se 4 orë në ditë. Trend i ngjashëm vërehet edhe në rezultatet e vendeve fqinje të Kosovës, si dhe në mesataren e OECD.

6.4. Qëndrimet rreth karrierës

Një grup prej 9 pyetjesh nga anketa me nxënësit i kushtohet qëndrimeve rreth karrierës dhe rolit të shkollës në përgatitjen për jetë. Në tabelën 20 janë dhënë përgjigjet e nxënësve në disa prej këtyre pyetjeve dhe performanca e tyre në matematikë në varësi të këtyre përgjigjeve.

Pyetjet dhe përgjigjet e nxënësve tregojnë se si ndihen ata për informacionin që kanë marrë në lidhje me mundësitë e tyre të karrierës pas përfundimit të arsimit të detyruar dhe rolin që shkolla ka luajtur në përgatitjen e tyre për jetë, pas shkollës. Për shembull, nxënësit që deklarohen “plotësisht dakord” se janë të informuar mirë rreth rrugëve të tyre të mundshme pas klasës së nëntë, kanë arritur pikët më të larta në testin e matematikës. Kjo mund të tregojë një lidhje midis një ndjenje të sigurisë në lidhje me të ardhmen dhe midis suksesit akademik.

Nga ana tjetër, nxënësit që shprehin mospajtimin se shkolla ka qenë një humbje kohe duket se kanë performancë më të lartë në matematikë. Ndërkaq, nuk shihet dallim i qartë në performancë në mes të nxënësve që e shohin nga kënde të ndryshme kontributin e shkollës për përgatitjen e tyre për jetë.

TABELA 20. Performanca e nxënësve në matematikë varësisht nga qëndrimet ndaj karrierës

Në çfarë mase jeni ose nuk jeni dakord me deklaratat e mëposhtme?	Nuk jam aspak dakord	Nuk jam dakord	Dakord	Plotësisht dakord
Ndihem i mirë informuar rreth rrugëve të mia të mundshme pas klasës së nëntë	343	364	369	371
	14.2%	20.8%	51.5%	13.5%
Shkolla ka qenë një humbje kohe	373	368	353	334
	36.8%	31.5%	23.2%	8.5%
Shkolla ka bërë pak për të më përgatitur për jetën e të rriturve pas largimit nga shkolla	352	367	367	360
	16.0%	30.8%	41.1%	12.1%

Burimi: PISA Data Explorer; PISA 2022 SPSS Data Files

7. Klima shkollore

Klima shkollore përshkruhet si “cilësia dhe karakteri i jetës shkollore” dhe përfshin marrëdhëniet ndërmjet nxënësve, personelit të shkollës dhe prindërve. Kjo klimë mund të jetë e sigurt ose e pasigurt, e bashkuar ose e ndarë, bashkëpunuese ose konkurruese. Klima pozitive shkollore karakterizohet nga ndjenja e sigurisë fizike dhe emocionale e nxënësve, mësimdhënësit mbështetës, pjesëmarrja vullnetare e prindërve në aktivitete shkollore dhe ndërtimi i një komuniteti rreth marrëdhënieve të shëndetshme dhe bashkëpunuese. Konceptet siç janë mjedisi shkollor, mjedisi i mësimi dhe kultura shkollore janë të ngjashme me klimën shkollore. Ky koncept multidimensional reflekton përvojën e përgjithshme shkollore, duke përfshirë sjellje jo të përshtatshme siç janë ngacmimi dhe mungesa, si dhe aspektet e mësimdhënies, si mbështetja akademike dhe entuziazmi i mësimdhënësve.¹³

Këtu do t'i analizojmë vetëm disa aspekte të klimës shkollore, përfshirë sigurinë dhe sjelljen e nxënësve, bullizmin dhe disiplinën në orët e matematikës.

7.1. Siguria dhe sjellja e nxënësve

Pyetësi i nxënësve përmban një numër të konsiderueshëm pyetjesh lidhur me klimën shkollore, ku tri prej tyre janë të fokusuar në perceptimin e nxënësve të sigurisë personale. Shpërndarja e përgjigjeve në këto pyetje është prezantuar në Tabelën 21, krahasuar me mesataren e arritjeve në matematikë të nxënësve nga çdo kategori.

TABELA 21. Performanca e nxënësve në matematikë varësisht nga perceptimi i sigurisë personale

Në çfarë mase jeni ose nuk jeni dakord me deklaratat e mëposhtme?	Plotësisht dakord	Dakord	Nuk jam dakord	Nuk jam aspak dakord
Unë ndihem i/e sigurt kur kthehem nga shkolla për në shtëpi	377	374	357	346
	49.0%	40.2%	8.3%	2.5%
Unë ndihem i/e sigurt në klasën time	363	358	336	333
	48.5%	34.9%	4.6%	1.3%
Unë ndihem i/e sigurt në ambientet e tjera të shkollës (p.sh. korridor, mensë, tualet)	361	364	352	328
	46.8%	39.9%	9.7%	3.7%

Burimi: PISA Data Explorer; PISA 2022 SPSS Data Files

Rreth 88% e nxënësve që morën pjesë në test janë përgjigjur në këto pyetje. Nga të dhënat e Tabelës 21, vërehet se nxënësit që ndihen më të sigurt, qoftë në klasë, në shkollë, apo kur kthehen në shtëpi, kanë tendencë të kenë performancë më të mirë në testin e matematikës. Kjo sugjeron një lidhje në mes perceptimit të sigurisë personale dhe të performancës akademike. Ndjenja e sigurisë mund të kontribuojë në një mjedis më të përshtatshëm për mësim, ku nxënësit janë më të qetë dhe të përqendruar në detyrat e tyre akademike.

Pyetëtori për drejtorët e shkollave përmban një sërë pyetjesh që adresojnë klimën shkollore. Tabela 22 shfaq përgjigjet e drejtorëve për pesë nga këto pyetje dhe lidhjen e tyre me performancën e nxënësve në testin e matematikës. Nga 229 drejtorë të shkollave, 193-194 prej tyre janë përgjigjur në çdo pyetje të specifikuar. Nga të dhënat e paraqitura në Tabelën 22, vihet re se ekziston një lidhje në mes të disa aspekteve të klimës shkollore dhe të performancës së nxënësve në matematikë, veçanërisht në rastin e mungesave të paarsyetuara. Megjithatë, kjo lidhje nuk është e drejtpërdrejtë dhe e qartë.

Kjo situatë mund të shpjegohet nga fakti se performanca e nxënësve ndikohet nga shumë faktorë, si edukimi në shtëpi, aftësitë individuale, interesat dhe mbështetja që marrin jashtë shkollës. Gjithashtu, një numër i kufizuar i respondentëve dhe perceptimet e tyre subjektive mund të kenë ndikuar në rezultatet e anketës.

TABELA 22. Klima shkollore (sipas drejtorëve) dhe performanca në matematikë

Në shkollën tuaj, deri në çfarë mase pengohet mësimi i nxënësve nga dukuritë e mëposhtme?	Aspak	Shumë pak	Deri në njëfarë mase	Shumë
Mungesat e pajustificuara të nxënësve	372	368	349	346
	4.6%	36.1%	38.1%	21.1%
Nxënësit lënë orët e mësimit	375	357	340	350
	24.7%	44.3%	21.6%	9.3%
Mungesa e respektit të nxënësve për mësuesit	361	359	343	357
	25.9%	39.9%	22.8%	11.4%
Përdorimi i alkoolit ose drogave të paligjshme nga nxënësit	357	340	366	367
	78.8%	12.4%	1.0%	7.8%
Nxënës që frikësojnë ose keqtrajtojnë nxënës të tjerë	359	349	350	372
	49.7%	39.4%	5.2%	5.7%

Burimi: PISA Data Explorer; PISA 2022 SPSS Data Files

7.2. Bullizmi

Që nga cikli i PISA i vitit 2015, pyetësi për nxënës ka përfshirë pyetje në lidhje me bullizmin. Nxënësve u kërkohet të raportojnë nëse kanë qenë viktime të bullizmit, duke përfshirë përjashtimin nga nxënësit e tjerë dhe format e ndryshme të dhunës verbale dhe fizike. Është vënë re një tendencë globale e zvogëlimit të bullizmit që nga viti 2015, megjithëse ka disa përjashtime. Sa i përket vendeve të Ballkanit Perëndimor, krahasimi është bërë mes cikleve të PISA të viteve 2018 dhe 2022, pasi të dhënat për vitin 2015 janë në dispozicion vetëm për Malin e Zi.

Tabela 23 sjell informacion mbi frekuencën e formave të ndryshme të bullizmit në vitin 2022 dhe ndryshimet krahasuar me vitin 2018. Për Maqedoninë e Veriut, të dhënat për ndryshimin mungojnë, pasi pyetjet rreth bullizmit nuk ishin përfshirë në pyetësin e vitit 2018. Në përputhje me tendencat globale, edhe në Kosovë dhe vendet fqinje vërehet një trend i qartë i zvogëlimit të të gjitha formave të bullizmit, që mund të jetë pasojë e angazhimeve të veçanta në këtë fushë, si nga ana e autoriteteve arsimore ashtu edhe nga institucionet jashtëshkollore.

Megjithatë, vërehet se frekuenca e pesë prej gjashtë formave të bullizmit të identifikuar në Tabelën 23 është raportuar të jetë më e lartë në Kosovë krahasuar me vendet fqinje. Kjo tregon nevojën e një angazhimi më të thelluar për të zvogëluar prezencën e bullizmit në shkolla në Kosovë.

TABELA 23. Frekuenca e formave të ndryshme të bullizmit në vitin 2022 dhe ndryshimi nga viti 2018

Shteti	Nuk jam përfshirë me qëllim në aktivitete nga nxënësit e tjerë.	Jam tallur nga nxënësit	Jam kërcënuar nga nxënësit	Nxënësit më kanë marrë ose shkatërruar gjërat e mia	Jam goditur ose shtyrë nga nxënësit	Nxënësit kanë përhapur thashetheme të këqija për mua
	%	%	%	%	%	%
Kosova 2022	15.8	9.5	4.5	7.1	7.7	13.3
Ndryshimi nga viti 2018	-2.0	-1.7	-5.5	-4.2	-3.7	-1.1
Shqipëria 2022	14.0	8.8	5.8	7.4	6.8	9.5
Ndryshimi nga viti 2018	-3.0	0.1	-1.7	-1.5	-1.7	-1.0
Mali i Zi 2022	5.1	8.1	6.8	4.1	3.6	9.9
Ndryshimi nga viti 2018	-4.7	-2.9	-4.7	-6.4	-6.5	-5.2
Maqedonia e Veriut 2022	7.3	7.5	4.0	4.6	4.8	8.5
Serbia 2022	6.4	7.5	3.5	3.7	2.7	9.2
Ndryshimi nga viti 2018	-5.7	-4.3	-7.4	-7.0	-8.1	-6.2
OECD 2022	7.0	11.8	3.2	3.4	3.9	7.1
Ndryshimi nga viti 2018	-1.8	-1.9	-3.1	-3.2	-3.0	-3.5

Burimi: PISA 2022 Results (Volume II), Table II.B1.3.33

Tabela 24 jep një pasqyrë të performancës së nxënësve në testin e matematikës në varësi të ekspozimit të tyre ndaj formave të ndryshme të bullizmit, siç është raportuar nga ta. Është interesante të vërehet se nxënësit që janë bullizuar (ngacmuar) më shpesh (“disa herë në muaj” ose “një herë në javë ose më shpesh”) kanë performancë më të ulët në krahasim me ata që nuk janë bullizuar ose janë bullizuar më rrallë. Kjo sugjeron një ndikim negativ të bullizmit në performancën akademike të nxënësve.

TABELA 24. Performanca e nxënësve në matematikë varësisht nga ekspozimi i formave të ndryshme të bullizmit

Gjatë 12 muajve të fundit, sa shpesh jeni përballur në shkollë me situatat e mëposhtme?	Kurrë ose pothuajse kurrë	Disa herë në vit	Disa herë në muaj	Një herë në javë ose më tepër
Nuk jam përfshirë me qëllim në aktivitete nga nxënësit e tjerë.	362	359	347	342
Jam tallur nga nxënësit	360	367	356	346
Jam kërcënuar nga nxënësit	363	355	325	323
Nxënësit më kanë marrë ose shkatërruar gjërat e mia	362	364	339	337
Jam goditur ose shtyrë nga nxënësit	364	351	340	343
Nxënësit kanë përhapur thashetheme të këqija për mua	363	365	345	337

Burimi: PISA Data Explorer

Ndikimi i bullizmit në performancën akademike mund të jetë rezultat i një numri faktorësh, përfshirë ndikimin në mirëqenien emocionale dhe shqetësimet mendore që mund të shpërqendrojnë nxënësit nga mësimi. Gjithashtu, nxënësit që përjetojnë bullizëm mund që, të kenë më pak motivim të marrin pjesë aktivisht në mësim, dhe të ndihen më pak të sigurt në mjedisin shkollor.

Përveç ndikimit të drejtpërdrejtë në performancën akademike, bullizmi gjithashtu mund të ketë efekte afatgjata në zhvillimin e aftësive sociale dhe atyre emocionale të nxënësve, duke ndikuar në mënyrë të përhershme në rrugëtimin e tyre arsimor dhe atë profesional. Prandaj, rezultatet e tabelës 24 nxisin një diskutim më të gjerë mbi nevojën për strategji efikase në luftimin e bullizmit në shkolla dhe në mbështetjen e nxënësve që janë viktimat e tij.

7.3. Disiplina në orët e matematikës

Nxënësve u është bërë pyetja se sa shpesh ndodhin gjëra të caktuara në orët e tyre të matematikës, siç janë situatat kur “Nxënësit nuk dëgjojnë çfarë thotë mësuesi” apo “Ka zhurmë dhe rrëmujë”. Nga përgjigjet e dhëna në 7 pyetje të këtij lloji është krijuar “indeksi i klimës disiplinore” (DISCLIM), me një mesatare prej 0 dhe devijim standard prej 1, bazuar në të dhënat e vendeve të OECD. Vlera pozitive në këtë indeks tregon për një klimë disiplinore më të mirë në krahasim me mesataren në vendet e OECD, ndërsa tregon një vlerë negative për një klimë më të keqe. Kosova ka një indeks prej -0.09, që është më i ulët se në vendet fqinje. Tabela 25 paraqet shpërndarjen e përgjigjeve të nxënësve për çdo pyetje të këtij grupi.

TABELA 25. Klima disiplinore në orët e matematikës

Sa shpesh ndodhin këto gjëra në orët tuaja të matematikës?	Në çdo orë mësimi	Në shumicën e orëve të mësimi	Në disa orë mësimi	Asnjëherë ose pothuajse kurrë
Nxënësit nuk dëgjojnë çfarë thotë mësuesi	17.9%	18.0%	46.6%	17.5%
Ka zhurmë dhe rrëmujë	13.4%	14.7%	43.4%	28.6%
Mësuesi duhet të presë për një kohë të gjatë derisa nxënësit të qetësohen	13.6%	16.8%	39.6%	30.0%
Nxënësit nuk mund të punojnë mirë	11.6%	18.6%	44.8%	25.0%
Pas fillimit të mësimi, nxënësit nuk fillojnë nga puna për një kohë të gjatë	12.1%	15.9%	37.1%	35.0%
Nxënësit shpërqendrohen nga përdorimi i resurseve digjitale (p.sh. smartphone, website, aplikacione)	13.1%	16.9%	33.5%	36.5%
Nxënësit shpërqendrohen nga nxënësit e tjerë që përdorin burimet digjitale (p.sh. smartphone, website, aplikacione).	12.0%	15.2%	33.8%	39.0%

Burimi: PISA 2022 SPSS Data Files

Nuk shfaqet një korrelacion i qartë midis indeksit të klimës disiplinore dhe të performancës mesatare në testin e matematikës. Megjithatë, një përjashtim vërehet në rastin e shteteve/ekonomive me performancë të lartë, ku shihen vlera të larta në indeksin e klimës disiplinore. Për shembull, Japonia ka një indeks të klimës disiplinore prej 1.02, Korea e Jugut - 0.84, Taiwan - 0.34, Singapori - 0.22, Lituania - 0.21 dhe Zvicra - 0.11. Kjo tregon se një mjedis më i disiplinuar në klasë mund të lidhet me performancë më të mirë në disa kontekste.

8. Burimet njerëzore dhe materiale

Ky kapitull trajton burimet njerëzore dhe materiale në kontekstin e arsimit dhe ndikimin e tyre në performancën e nxënësve sipas rezultateve të PISA. Përmes analizës së shpenzimeve publike për arsim dhe të faktorëve si raporti mësimdhënës-nxënës, kualifikimi i mësimdhënësve, si dhe disponueshmëria e cilësia e infrastrukturës fizike dhe e materialeve mësimore në shkolla, shqyrtohet kontributi i këtyre faktorëve në suksesin ose në dështimin e nxënësve në PISA.

8.1. Shpenzimet për arsim

Vëllimi i shpenzimeve publike për arsim reflekton angazhimin e Qeverisë ndaj zhvillimit arsimor të vendit. Sipas UNESCO-s, rekomandohet që shtetet të alokojnë 4-6% të Bruto Produktit Vendor (BPV) për arsim dhe 15-20% të buxhetit qeveritar total për këtë qëllim, varësisht nga konteksti ekonomik dhe prioritetet kombëtare. Në vitin 2022, Kosova ka dedikuar 3.9% të BPV-së dhe 13.4% të shpenzimeve qeveritare totale për arsim, duke u renditur paksa poshtë këtyre standardeve të rekomanduara nga UNESCO. Megjithatë, krahasuar me vendet e tjera në rajon, Kosova nuk qëndron aspak keq në aspektin e përqindjeve të alokimit të fondeve, edhe pse mbetet poshtë mesatares së vendeve të OECD-së.

TABELA 26. Shpenzimet publike për arsim në raport me BPV dhe shpenzimet e përgjithshme të Qeverisë

Shteti	Mesatarja në Matematikë	Shpenzimet për arsim si përqindje e BPV	Shpenzimet për arsim si përqindje e shpenzimeve të Qeverisë	Viti i të dhënave	Burimi
Kosova	355	3.9%	13.4%	2022	Raport vjetor statistikor me tregues arsimorë 2022-2023 - https://masht.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/12/Raport-vjetor-statistikor-me-tregues-arsimore-2022-2023.pdf
Shqipëria	368	3.1%	9.8%	2021	https://data.worldbank.org/indicator/SE.XPD.TOTL.GD.ZS
Mali i Zi	406	3.8%	8.2%	2019	https://www.unicef.org/montenegro/media/22591/file/ESA%20-%20ENG.pdf
Maqedonia e Veriut	389	3.7%	11.6%	2016	https://www.oecd-ilibrary.org/sites/9b99696c-en/index.html?itemId=/content/component/9b99696c-en#:~:text=Public%20spending%20on%20education%20has,has%20declined%20in%20recent%20years.
Serbia	440	3.3%	7.1%	2022	https://data.worldbank.org/indicator/SE.XPD.TOTL.GD.ZS
OECD	472	4.3%		2020	https://data.oecd.org/eduresource/public-spending-on-education.htm

Edhe pse rëndësia e investimit në arsim është e pakontestueshme, të dhënat tregojnë se vetëm shtimi i shpenzimeve nuk garanton përmirësimin e performancës së nxënësve në testet ndërkombëtare si PISA. Analizat e detajuara nga OECD vënë në dukje se përmirësimi i cilësisë arsimore kërkon një qasje më të gjithanshme, përfshirë strategji të mirë-menduara dhe investime të përqendruara, jo vetëm në infrastrukturë, por edhe në zhvillimin profesional të mësimitdhënësve, përmirësimin e metodave të mësimitdhënies, dhe nxitjen e pjesëmarrjes së nxënësve.

8.2. Burimet njerëzore

Në shkollat ku u zhvillua testimi PISA, janë grumbulluar të dhëna për numrin total të nxënësve dhe të mësimitdhënësve për të kalkuluar raportin mësimitdhënës-nxënës. Në Kosovë, ky raport është 13.9, gjë që e vendos atë mbi mesataren e OECD-së, e cila është 13.2. Nga ana tjetër, në vendet fqinje, përveç Shqipërisë (13.9), raporti mësimitdhënës-nxënës në shkollat që janë marrë parasysh është më i ulët se mesatarja e OECD-së: në Malin e Zi 11.5, në Maqedoninë e Veriut 13.5, dhe në Serbi vetëm 11.¹⁴ Raporti i favorshëm mësimitdhënës-nxënës është një tregues i rëndësishëm që ndikon në cilësinë e arsimit, duke ua ofruar mësimitdhënësve mundësinë të përqendrohen më mirë te nevojat individuale të nxënësve dhe të krijojnë një mjedis më të qetë e më produktiv mësimit. Megjithatë, një raport i favorshëm nuk është domosdoshmërisht një formulë për sukses. Përkundrazi, në disa raste, mund të sinjalizojë shpenzimin joracional të burimeve financiare, veçanërisht nëse investimet në numrin e mësimitdhënësve nuk shoqërohen me përmirësimin e metodave mësimit, materialeve didaktike dhe të infrastrukturës arsimore.

TABELA 27. Përqindja e mësimitdhënësve të kualifikuar dhe diferenca në performancën në matematikë

Shteti	Mësimitdhënës të kualifikuar	Diferenca në performancën në matematikë për çdo rritje prej 10 njësisish në përqindjen e mësimitdhënësve të kualifikuar në shkollë	
		Diferenca para normalizimit të rezultatit sipas ESCS	Diferenca pas normalizimit të rezultatit sipas ESCS
Kosova	82.8%	1	0
Shqipëria	81.7%	2	1
Mali i Zi	77.1%	1	1
Maqedonia e Veriut	67.3%	1	1
Serbia	71.2%	0	1
OECD	83.3%	1	0

Burimi: Pisa 2022 Results, Volume II, Table II.B1.5.9, Table II.B1.5.10

Tabela 27 tregon përqindjen e mësimitdhënësve të kualifikuar në shkollat që morën pjesë në PISA. Shkollat në Kosovë tregojnë një përqindje të kënaqshme të mësimitdhënësve të kualifikuar, krahasuar me mesataren e OECD-së. Sidoqoftë, rritja e supozuar e numrit të mësimitdhënësve të kualifikuar nuk rezultoi në përmirësim të dukshëm të performancës në matematikë. Nëse shkollat në Kosovë do të kishin një rritje prej 10 njësi të përqindjes në numrin e mësimitdhënësve të kualifikuar - duke arritur në 92.8% nga 82.8% që është aktualisht - përmirësimi në performancën në matematikë do të ishte minimal, vetëm një pikë. Ky përmirësim bëhet edhe më i pavërejtur kur rezultatet normalizohen sipas statusit socio-ekonomik të nxënësve, duke mos treguar ndonjë ndryshim të rëndësishëm nga situata aktuale. Situata e ngjashme është edhe në nivelin e vendeve të OECD dhe të vendeve fqinje të Kosovës.

Tabela 28 paraqet përqindjen e nxënësve në ato shkolla ku drejtorët raportojnë për një mungesë të personelit mësues ose për praninë e personelit që nuk është adekuat ose i kualifikuar. Në këto dy kategori, Kosova shënon një përqindje më të lartë të nxënësve në krahasim me shtetet fqinje, por regjistron një përqindje më të ulët në krahasim me vendet anëtare të OECD-së.

TABELA 28. Përqindja e nxënësve në shkollat ku drejtorët kanë deklaruar vështirësi rreth personelit mësimit

Shteti	Mungesa e personelit mësimit	Personeli mësimit joadekuat ose i pakualifikuar
Kosova	27.1%	12.9%
Shqipëria	14.9%	6.7%
Mali i Zi	26.9%	9.7%
Maqedonia e Veriut	14.6%	3.6%
Serbia	18.4%	10.1%
OECD	46.7%	25.4%

Burimi: Pisa 2022 Results, Volume II, Table II.5

Performanca e nxënësve në testin e matematikës, e cila varet nga përgjigjet e drejtorëve lidhur me sfidat e stafit mësimit, është paraqitur në tabelat 29 dhe 30. Analiza e të dhënave tregon se në vendet e OECD ekziston një lidhje në konsistencë midis performancës së nxënësve dhe raporteve të drejtorëve rreth mungesës së personelit mësimit ose të personelit joadekuat ose të pakualifikuar. Për shembull, në shkollat pa mungesë të ndjeshme të personelit mësimit, mesatarja e pikëve është 480, ndërsa në ato me një problem të theksuar të mungesës së personelit, mesatarja është 461 (Tabela 29).

TABELA 29. Performanca e nxënësve në matematikë varësisht nga mungesa e personelit mësimit

Shteti	Mungesa e personelit mësimit			
	Aspak	Shumë pak	Deri diku	Shumë
Kosova	342	366	355	345
Shqipëria	368	355	379	364
Mali i Zi	410	391	412	402
Maqedonia e Veriut	388	388	396	371
Serbia	437	443	438	468
OECD	480	477	469	461

Burimi: PISA Data Explorer

Trend i ngjashëm vërehet edhe në rastin e raporteve për personelin adekuat dhe të kualifikuar në vendet e OECD (Tabela 30). Nga ana tjetër, në vendet e Ballkanit Perëndimor, nuk është i qartë një model i përcaktuar i performancës bazuar në deklaratat e drejtorëve. Për shembull, në Kosovë, nxënësit nga shkollat ku drejtorët kanë raportuar mungesë minimale të personelit mësimor (“shumë pak”) kanë shfaqur performancë më të mirë (Tabela 29), ndërsa ato ku është raportuar për një prani të madhe të personelit mësimor jo adekuat dhe të pakualifikuar (“shumë”) kanë treguar gjithashtu performancë më të mirë krahasuar me kategoritë e tjera (Tabela 30).

TABELA 30. Performanca e nxënësve në matematikë varësisht nga përshtatshmëria e personelit mësimor

Personeli mësimor joadekuat ose i pakualifikuar				
Shteti	Aspak	Shumë pak	Deri diku	Shumë
Kosova	360	350	329	362
Shqipëria	372	360	365	358
Mali i Zi	411	394	419	⊕
Maqedonia e Veriut	389	394	361	⊕
Serbia	444	430	448	⊕
OECD	480	474	463	453

⊕ - nuk janë plotësuar standardet e raportimit

Burimi: PISA Data Explorer

Në pyetësorin drejtuar drejtorëve, disa pyetje janë të përqendruara në zhvillim profesional të personelit. Këtu, jemi përqendruar në një pyetje që përmban tri deklaratave të ndryshme, të cilat janë paraqitur në tabelën 31. Kjo tabelë ofron të dhëna mbi performancën e nxënësve në testin e matematikës në varësi të përgjigjeve të drejtorëve ndaj këtyre deklaratave, së bashku me përqindjen e drejtorëve që kanë zgjedhur secilën përgjigje. Nga të dhënat e tabelës, rezulton se organizimi i trajnimeve profesionale ndikon në përmirësimin e performancës së nxënësve në testin e matematikës, gjë e cila vërehet si në Kosovë ashtu edhe në vendet e OECD. Megjithatë, një dallim kryesor mes Kosovës e vendeve të OECD është përqindja e shkollave që mbajnë trajnime: në Kosovë, kjo përqindje ndryshon nga 45 në 55%, ndërsa në vendet e OECD ajo është ndërmjet 70 dhe 82%.

TABELA 31: Organizimi i trajnimeve për personelin në raport me performancën në matematikë

Cilat nga llojet e mëposhtme të zhvillimit profesional ekzistojnë në shkollën tuaj?	Kosova		OECD	
	Po	Jo	Po	Jo
Shkolla jonë, fton specialistë për të kryer trajnime në shërbim të mësimdhënësve	358	350	475	464
	53.3%	46.7%	80.2%	19.8%
Shkolla jonë, organizon workshop-e për çështje specifike, me të cilat përballemi	358	351	474	469
	49.2%	50.8%	82.0%	18.0%
Shkolla jonë, organizon workshop-e në shërbim të grupeve specifike të mësuesve (p.sh. mësuesit e emëruar rishtazi)	358	352	475	471
	45.4%	54.6%	70.6%	29.4%

Burimi: PISA Data Explorer; PISA 2022 SPSS Data Files

8.3. Burimet materiale

Burimet materiale në shkollë përfshijnë materialet mësimore dhe infrastrukturën fizike.

Materialet mësimore janë thelbësore për sigurimin e një cilësie të lartë të procesit mësimor në shkolla. Ato përfshijnë një spektër të gjerë burimesh dhe mjetesh që mbështesin dhe pasurojnë përvojën e të mësuarit duke u ofruar nxënësve qasje në njohuri dhe duke i ndihmuar ata të kuptojnë dhe t'i zbatojnë konceptet në praktikë. Këto materiale mund të ndryshojnë nga librat dhe tekstet shkollore, të cilat ofrojnë një strukturë themelore të përmbajtjes programore, deri te burimet digjitale dhe ndërvepruese që ofrojnë përvoja mësimore më dinamike dhe të personalizuara. Në përgjithësi, një gamë e larmishme dhe e pasur e materialeve mësimore mund të ndihmojë në adresimin e stileve të ndryshme të të mësuarit të nxënësve, duke i bërë mësimet më tërheqëse dhe më efektive. Materialet si modulet e e-learning, aplikacionet edukative, lojërat mësimore dhe pajisjet laboratorike janë veçanërisht të dobishme në këtë aspekt, pasi ato ofrojnë mundësi të shumta për eksplorim dhe eksperimentim. Gjithashtu, materialet mësimore të cilësisë së lartë janë kritike për të zvogëluar hendekun e performancës midis nxënësve nga sfondet e ndryshme socio-ekonomike, duke siguruar që të gjithë kanë qasje në burime të pasura dhe stimuluese edukative.

Infrastruktura fizike - që përfshin ndërtesat shkollore, klasat, laboratorët, bibliotekat dhe hapësirat rekreative/sportive - është po aq thelbësore sa dhe materialet mësimore për sigurimin e një arsimit cilësor. Infrastruktura e mirëmbajtur dhe e përshtatshme ndikon drejtpërdrejt në kushtet e mësimit dhe mirëqenien e nxënësve e të mësimdhënësve duke krijuar një mjedis të sigurt, të përshtatshëm dhe stimulues për të dyja palët.

Pyetësi për drejtorë përmban një varg pyetjesh rreth disponueshmërisë, cilësisë dhe shfrytëzimit të infrastrukturës fizike si dhe materialeve mësimore në shkollë, me qëllim që të kuptohet më lehtë realiteti i sistemit të caktuar arsimor dhe të vendoset një ndërlidhje me performancën e nxënësve në test.

Një përmbledhje e përgjigjeve të drejtorëve në lidhje me faktorët pengues për organizimin e procesit mësimor në shkollë është paraqitur në tabelën 32. Sipas kësaj tablele, në shkollat e Kosovës ku drejtorët raportojnë se mungojnë materialet mësimore në një masë të konsiderueshme vijojnë mësimet më shumë se 70% e nxënësve që kanë marrë pjesë në testin PISA, një shifër që tejkalon mesataren e vendeve të OECD-së dhe të vendeve fqinje të Kosovës. Gjithashtu, 69.1% e nxënësve në Kosovë ndjekin mësimet

TABELA 32. Përgjigjet e drejtorëve në pyetjen rreth faktorëve pengues për organizimin e procesit mësimor në shkollë

Shteti	Indeksi I mungesës së materialeve mësimore	Përqindja e nxënësve në shkollat ku drejtorët kanë raportuar se kapaciteti i shkollës për të organizuar procesin mësimor pengohet nga:							
		Mungesa e materialeve mësimore				Materiale mësimore jo adekuate ose pa cilësi			
		1	2	3	4	1	2	3	4
Kosova	1.00	12.4	17.4	35.2	35.0	14.5	16.3	41.4	27.7
Shqipëria	0.32	31.5	14.6	35.7	18.1	35.0	17.8	37.0	10.3
Mali i Zi	0.67	14.4	18.1	54.1	13.4	6.8	36.0	42.1	15.1
Maqedonia V	0.23	28.8	16.4	34.6	20.2	29.6	25.4	28.1	16.8
Serbia	m	34.5	33.4	26.1	6.0	31.1	32.1	32.1	4.7
OECD	-0.17	47.1	29.0	17.3	6.5	46.8	31.4	16.4	5.3

1=aspak, 2=shumë pak, 3=deri diku, 4=shumë m-mungon

në shkolla ku drejtorët theksojnë se materialet mësimore janë joadekuate ose të pakënaqshme për nga cilësia. Rezultate të ngjashme u vërejtën kur u pyetën drejtorët nëse disponojnë pajisje digjitale dhe nëse ato janë të cilësisë së kërkuar. Megjithatë, diferenca me vendet fqinje është pak më e ngushtë kur bëhet fjalë për infrastrukturën fizike të shkollave.

Mungesa e infrastrukturës fizike				Infrastrukturë fizike joadekuate dhe me cilësi të dobët				Mungesa e resurseve digjitale				Resurse digjitale të pamjaftueshme ose me cilësi të dobët			
1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4
23.0	24.1	31.3	21.6	27.4	23.9	31.4	17.3	13.9	16.7	35.0	34.3	13.7	15.2	35.6	35.5
43.2	18.0	25.4	13.4	43.2	19.7	24.4	12.7	23.8	14.3	31.5	30.5	21.2	13.9	34.3	30.7
36.8	23.9	27.5	11.8	34.4	31.8	16.7	17.1	7.5	26.1	43.1	23.3	7.4	27.2	45.0	20.5
63.5	13.4	16.9	6.3	63.9	12.0	15.9	8.1	35.8	26.1	22.3	15.7	38.4	22.5	23.5	15.6
50.1	15.7	23.3	10.8	42.9	22.0	21.6	13.5	28.7	35.8	28.6	6.8	28.6	35.8	30.2	5.3
46.5	24.4	18.9	10.1	46.4	25.7	18.0	9.9	47.2	28.8	16.1	7.8	45.5	29.9	17.1	7.5

Nga gjashtë aspektet e trajtuara në tabelën 33 – mungesa dhe cilësia e materialeve mësimore, mungesa dhe cilësia e infrastrukturës fizike, si dhe mungesa dhe cilësia e pajisjeve digjitale – është krijuar indeksi i mungesës së burimeve materiale (EDUSHORT). Vlerat pozitive në këtë indeks tregojnë se drejtorët e konsiderojnë sasinë dhe/ose cilësinë e burimeve materiale në shkollat e tyre si një pengesë më të madhe për ofrimin e mësimin në krahasim me mesataren e vendeve që morën pjesë në test. Ndërkohë, vendet e OECD shfaqin një indeks negativ, ndërsa Kosova ka një indeks të lartë pozitiv në krahasim me vendet fqinje. Faktikisht, vetëm pesë shtete/ekonomi pjesëmarrëse kanë një indeks më të lartë se Kosova: Xhamajka me 1.02, Mongolia me 1.09, Autoriteti Palestinez me 1.14, Maroku me 1.26 dhe Kostarika gjithashtu me 1.26.

Tabela 33 ofron një panoramë të përgjigjeve të drejtorëve në lidhje me materialet mësimore në varësi të karakteristikave të ndryshme të shkollave. Këto përgjigje janë paraqitur përmes një indeksi të mungesës së materialeve mësimore (EDUSHORT). Analiza e të dhënave tregon dallime të konsiderueshme mes shkollave në kategorinë e shkollave të cenueshme, atyre me një përqindje të lartë nxënësish nga familje me gjendje të dobët socio-ekonomike, dhe shkollave të favorizuara. Për shkollat e cenueshme në Kosovë, indeksi është 1.35, që është më i lartë se mesatarja e vendit prej 1.00, ndërsa për shkollat e favorizuara indeksi është vetëm 0.54. Gjithashtu, vërehet një ndryshim edhe më i theksuar mes shkollave publike dhe atyre private, ku të fundit shfaqin një indeks me vlerë negative. Kjo tregon një mungesë shumë më të vogël të burimeve materiale në shkollat private krahasuar me ato publike.

Sa i përket vendndodhjes së shkollës, drejtorët e shkollave urbane raportojnë se nevojat e tyre për materiale mësimore janë më pak të përmbushura në krahasim me ato në zonat rurale. Kjo mund të shpjegohet me zvogëlimin e vazhdueshëm të popullsisë shkollë në Kosovë, i cili, së bashku me investimet në materiale mësimore, ka mundësi të ketë kontribuar në përmirësimin e kushteve të punës në zonat rurale. Përkundrazi, disa shkolla urbane përballen me sfidën e mungesës së hapësirave të mjaftueshme, e cila sjell si pasojë edhe mungesën e materialeve mësimore.

TABELA 33. Indeksi i mungesës së materialeve mësimore (EDUSHORT) sipas karakteristikave të shkollave

Shteti	Sipas profilit socio-ekonomik të shkollës			Sipas lokacionit të shkollës			Sipas tipit të shkollës	
	Shkollat e cenueshme	Shkollat e profilit socio-ekonomik mesatar	Shkollat e favorizuara	Zonat rurale	Qytetet deri në 100 mijë banorë	Qytetet mbi 100 mijë banorë	Publike	Private
Kosova	1.35	1.05	0.54	0.81	1.01	1.03	1.13	-1.22
Shqipëria	0.69	0.47	-0.35	0.92	0.36	-0.10	0.54	-1.22
Mali i Zi	0.76	0.76	0.41	c	0.72	0.58	0.67	c
Maqedonia e Veriut	0.34	0.34	-0.10	-1.28	0.53	-0.02	0.23	-1.37
OECD	-0.07	-0.19	-0.39	-0.04	-0.13	-0.22	-0.09	-0.57

Tabela 34 ofron një pasqyrë të mënyrës se si drejtorët e shkollave perceptojnë gjendjen e burimeve materiale në institucionet që menaxhohen nga ta duke e krahasuar këtë me performancën e nxënësve në testin e matematikës. Analiza e të dhënave tregon një lidhje të qartë në vendet e OECD mes disponueshmërisë dhe cilësisë së burimeve materiale dhe të performancës së nxënësve në matematikë. Megjithatë, në Kosovë kjo tendencë nuk është aq e qartë. Përkundrazi, vërehen variacione që nxisin pyetje të reja, të cilat kërkojnë zgjidhje përmes hulumtimeve më të detajuara.

TABELA 34. Burimet materiale në raport me performancën në matematikë

A pengohet nga çështjet e mëposhtme mësimdhënia në shkollën tuaj?	Kosova				OECD			
	Aspak	Shumë pak	Deri diku	Shumë	Aspak	Shumë pak	Deri diku	Shumë
Mungesa e materialeve mësimore	362	357	357	350	479	470	464	456
Materiale mësimore jo adekuate ose pa cilësi	366	368	349	351	478	469	467	457
Mungesa e infrastrukturës fizike	361	354	355	349	476	472	470	467
Infrastruktura fizike joadekuate dhe me cilësi të dobët	360	358	352	349	477	472	467	466
Mungesa e resurseve digjitale	369	345	346	363	479	471	467	462
Resurse digjitale të pamjaftueshme ose me cilësi të dobët	367	354	345	362	479	471	468	459

Burimi: PISA Data Explorer

9. Ndikimi i Pandemisë COVID-19

Pandemia e COVID-19 shkaktoi ndryshime të papritura dhe të thella anembanë botës. Kjo ishte tronditja më e madhe për sistemet arsimore që prej dekadash, e shoqëruar me mbylljet më të gjata të shkollave dhe një recesion të pritshëm. Sipas informacioneve të mbledhura nga anketa me nxënësit pjesëmarrës në PISA 2022, ndërtesat shkollore kanë qenë të mbyllura, gjatë pandemisë, mesatarisht 4.4 muaj në vendet anëtare të OECD-së, 3.6 muaj në Kosovë, 4.1 muaj në Shqipëri, 4.3 muaj në Malin e Zi, 6 muaj në Maqedoninë e Veriut dhe 2.8 muaj në Serbi¹⁵. Në atë periudhë, në shumicën e këtyre vendeve u zbatua mësimi nga distanca. Në Kosovë, procesi mësimor u realizua përmes transmetimit televiziv të njësive mësimore dhe sesioneve mësimore që u zhvilluan përmes platformave digjitale të ndryshme.

Efektiviteti i mësimi në shtëpi për të gjithë popullacionin e nxënësve dhe ndikimi i tij në zhvillimin e aftësive mbetet pak i njohur. Sidoqoftë, ka sinjale nga disa shtete për efektivitetin e ulët të mësimi të organizuar gjatë pandemisë. Për një pjesë të rëndësishme të nxënësve, mësimi gjatë periudhës së mbylljes së shkollave ishte pothuajse jo-ekzistent¹⁶.

Në një studim të botuar në qershor 2020, tre muaj pas shpalljes së pandemisë, Banka Botërore vlerësoi se “humbja mësimore” për shkak të mbylljes së shkollave në vendet e Ballkanit Perëndimor do të rezultonte në rreth 9 pikë të PISA, duke pasur parasysh se 40 pikë të PISA, në atë kohë, konsideroheshin si të barasvlershme me një vit të plotë shkollor. Për nxënësit që nuk ishin pjesë e mësimi “online”, humbja mësimore vlerësohej të jetë 16 pikë të PISA, ose afërsisht 40% e një viti shkollor.¹⁷

Rënia e theksuar në rezultatet e PISA 2022 në krahasim me ato të PISA 2018 lë të kuptohet se pandemia e COVID-19 mund të ketë qenë një faktor ndikues në këtë tendencë negative. Sidoqoftë, analiza e tendencave të performancës në PISA para vitit 2018 zbulon se rezultatet në lexim dhe në shkencë kanë nisur të dobësohen gjatë kohë para se të shpërthente pandemia. Në këto disiplina, performanca

¹⁵ Pisa 2022 Results, Volume II, Table II.B1.2.1

¹⁶ Hanushek, Woessmann: The Economic Impacts of Learning Losses, September 2020. https://hanushek.stanford.edu/sites/default/files/publications/The%20Economic%20Impacts%20of%20Learning%20Losses_final_v1.pdf

¹⁷ World Bank: The Economic and Social Impact of COVID-19 - Education, Western Balkans Regular Economic Report No.17, Spring 2020. <https://documents1.worldbank.org/curated/en/590751590682058272/pdf/The-Economic-and-Social-Impact-of-COVID-19-Education.pdf>

arriti kulmin në vitin 2012 për lexim dhe në vitin 2009 për shkencë, përpara se të shënonte një rënie. Kjo sugjeron se në rezultatet e PISA kanë ndikuar edhe faktorë të tjerë afatgjatë. Përderisa në një numër shtetesh/ekonomish performanca e nxënësve ka mbetur e qëndrueshme ndër vite, në disa të tjera është vërejtur edhe një trend përmirësimi. Prandaj, ndikimi i pandemisë, edhe pse i dukshëm në rezultatet e fundit të PISA-s, nuk duhet të shihet si i vetmi shkaktar i rënies së performancës.

Këtu do të përqendrohemi në analizën e dy faktorëve që mund të kenë ndikuar në rezultatin e PISA, veçanërisht në kontekstin kosovar: problemet me mësimin nga distanca dhe të mësuarit në shtëpi. Është mirë e njohur se pandemia COVID-19 dhe mbyllja e plotë që ka pasuar në shumë vende, i ka zënë sistemet arsimore të papërgatitura për të ofruar një alternativë të duhur për shkollën. Në rastin e Kosovës, para pandemisë nuk ka ekzistuar ndonjë sistem për mësim nga distanca, kështu që i gjithë organizimi i mësimi, sidomos në muajt e fundit të vitit shkollor 2019/20, është karakterizuar me elemente të theksuara improvizimi.

Nxënësit që morën pjesë në testin PISA 2022 u pyetën për vështirësitë që hasën gjatë organizimit të mësimi në distancë, duke përfshirë sfidat me qasjen në pajisje digjitale dhe në internet, si dhe me marrjen e ndihmës për detyrat shkollore. Opsionet e përgjigjeve ishin “asnjëherë”, “disa herë”, “rreth një ose dy herë në javë” dhe “çdo ditë ose pothuajse çdo ditë”. Tabela 35 pasqyron përqindjen e atyre nxënësve që kanë deklaruar se nuk janë përballur me këto probleme ose i kanë hasur ato vetëm në mënyrë sporadike. Sipas kësaj tabele, 75.1% e nxënësve në Kosovë nuk kanë përjetuar probleme në përdorimin e pajisjeve digjitale, ndërsa 72% e tyre kanë pasur qasje të papenguar në internet. Po ashtu, rreth dy të tretat e nxënësve në Kosovë nuk kanë hasur pengesa në marrjen e ndihmës për detyrat e tyre shkollore.

TABELA 35. Problemet me mësimin nga distanca

Shteti	Përqindja e nxënësve që janë deklaruar se me problemet vijuese nuk janë përballur asnjëherë ose janë përballur disa herë:		
	Probleme me aksesin në pajisje digjitale kur më nevojitej	Probleme me aksesin në internet	Probleme me gjetjen e dikujt që të më ndihmonte me detyrat e shkollës
Kosova	75.1%	72.0%	66.6%
Shqipëria	66.2%	66.2%	61.4%
Mali i Zi	73.2%	73.4%	67.1%
Maqedonia e Veriut	70.4%	67.4%	64.3%
Serbia	80.0%	76.1%	69.9%
OECD	82.8%	77.9%	75.8%

Burimi: Pisa 2022 Results, Volume II, Table II.B1.2.30

Tabela 36 paraqet diferencat në rezultatet e testit të matematikës midis grupit të nxënësve të shënuar në tabelën 36 dhe atyre nxënësve që kanë raportuar për vështirësi me mësimin nga distanca. Kjo tabelë nxjerr në pah dallime të konsiderueshme në performancë ndërmjet këtyre dy grupeve të nxënësve, të cilat janë të qëndrueshme edhe pasi të jetë bërë normalizimi sipas indeksit të statusit socio-ekonomik dhe kulturor (ESCS).

TABELA 36. Problemet me mësimin nga distanca dhe performanca në matematikë

Shteti	Diferenca e pikëve në testin e matematikës për nxënësit që janë deklaruar se me problemet vijuese nuk janë përballur asnjëherë ose janë përballur disa herë:					
	Probleme me aksesin në pajisje digjitale kur më nevojitej		Probleme me aksesin në internet		Probleme me gjetjen e dikujt që të më ndihmonte me detyrat e shkollës	
	Para normalizimit sipas ECSC	Pas normalizimit sipas ESCS	Para normalizimit sipas ECSC	Pas normalizimit sipas ESCS	Para normalizimit sipas ECSC	Pas normalizimit sipas ESCS
Kosova	17	15	12	12	24	19
Shqipëria	18	17	16	19	30	31
Mali i Zi	24	18	19	15	21	15
Maqedonia e Veriut	23	18	22	17	31	23
Serbia	23	18	20	18	14	10
OECD	31	23	14	12	28	20

Burimi: Pisa 2022 Results, Volume II, Table II.B1.2.32

Nxënësit u anketuan gjithashtu mbi përvojën e tyre me mësimin në shtëpi. Për analizën, u zgjedhën tri deklaratat: 1) nëse nxënësit kanë ndier vetmi; 2) nëse kanë ndier ankth rreth detyrave të shkollës dhe 3) nëse kanë mbetur pas me detyrat e shkollës. Opsionet e përgjigjes ishin “nuk jam dakord”, “nuk jam aspak dakord”, “jam dakord” dhe “jam plotësisht dakord”. Tabela 37 paraqet përqindjet e nxënësve që nuk janë dakord ose aspak dakord me secilën nga këto deklaratat.

TABELA 37. Eksperienca e të mësuarit në shtëpi

Shteti	Përqindja e nxënësve që nuk janë dakord ose nuk janë aspak dakord me deklaratat vijuese		
	Jam ndier i/e vetmuar	Kisha ankth në lidhje me detyrat e shkollës	Mbeta mbrapa në detyrat e shkollës.
Kosova	67.0%	58.3%	57.9%
Shqipëria	64.5%	51.7%	51.2%
Mali i Zi	69.6%	54.3%	60.0%
Maqedonia e Veriut	64.0%	50.3%	50.6%
Serbia	70.3%	53.2%	62.5%
OECD	61.7%	53.4%	52.4%

Burimi: Pisa 2022 Results, Volume II, Table II.B1.2.24

Ndërkaq, tabela 38 tregon dallimet në rezultatet e testit të matematikës mes nxënësve që janë kategorizuar sipas përgjigjeve të tyre ndaj deklaratave të mësipërme dhe atyre që kanë qenë dakord ose plotësisht dakord me to. Edhe në këtë rast, janë evidentuar dallime të rëndësishme në performancë ndërmjet dy grupeve, si përpara ashtu edhe pas normalizimit të rezultateve sipas ESCS.

TABELA 38. Eksperienca e të mësuarit në shtëpi dhe performanca në matematikë

Shteti	Diferenca në pikët e testit të matematikës për nxënësit që nuk janë dakord ose nuk janë aspak dakord me deklaratat vijuese					
	Jam ndier i/e vetmuar		Kisha ankth në lidhje me detyrat e shkollës		Mbeta mbrapa në detyrat e shkollës.	
	Para normalizimit sipas ECSC	Pas normalizimit sipas ESCS	Para normalizimit sipas ECSC	Pas normalizimit sipas ESCS	Para normalizimit sipas ECSC	Pas normalizimit sipas ESCS
Kosova	11	7	15	15	12	11
Shqipëria	7	7	18	15	22	20
Mali i Zi	-1	1	12	11	25	18
Maqedonia e Veriut	10	10	14	14	6	5
Serbia	3	-1	7	7	10	4
OECD	-2	1	11	10	15	12

Burimi: Pisa 2022 Results, Volume II, Table II.B1.2.26

10. Përmbledhje e gjetjeve të studimit

Në vijim do të paraqiten përfundimet kyçe të studimit, të cilat pasqyrojnë gjetjet dhe analizat e detajuara të të dhënave të marra nga pjesëmarrja e nxënësve kosovarë në tri ciklet e fundit të testit PISA. Këto përfundime janë strukturuar në mënyrë që të ofrojnë një pasqyrë të qartë dhe të përmbledhur të sfidave dhe tendencave të vërejtura në performancën e nxënësve, ndikimin e faktorëve të ndryshëm socio-ekonomikë dhe arsimorë, si dhe në aspektet e tjera që kontribuojnë në situatën në të cilën ndodhet sistemi arsimor në Kosovë. Top of Form

- Rezultatet e nxënësve kosovarë në tri ciklet e fundit të testit PISA janë zhgënjyese, me rezultatet e PISA 2022 të cilat janë më të dobëtat deri tani. Kosova radhitet ndër të fundit në Lexim, Matematikë dhe Shkencë, ku 83% e nxënësve në Lexim, 85% e nxënësve në Matematikë, dhe 79% e tyre në Shkencë nuk e përmbushin standardin minimal të arritjeve (niveli 2 i performancës).
- Në tri ciklet e PISA ku ka marrë pjesë, Kosova nuk ka nxënës me arritje të larta në asnjërën nga tri disiplinat, ndryshe nga vendet fqinje ku 0.3-2% e nxënësve arrijnë nivelet 5&6 të performancës, ndërkohë që në vendet e OECD në mes 6.8 dhe 10.9% të nxënësve janë klasifikuar si nxënës me arritje të larta. Hendeku i performancës mes 10%-shit të nxënësve më të mirë dhe atyre më të dobët në Kosovë është 159 pikë në Matematikë, më i ngushtë se në vendet fqinje, ku hendeku arrin prej 211 deri në 229 pikë, ndërsa mesatarja e OECD është 235 pikë.
- Nga aspekti gjinor, vajzat në Kosovë performojnë më mirë se djemtë në Lexim dhe në Shkencë, ndërsa në Matematikë janë të barabartë, duke treguar përparim në barazinë gjinore në arsim.
- Statusi socio-ekonomik në Kosovë ka ndikim më të moderuar në performancën në Matematikë, me një diferencë prej 39 pikë mes 25%-shit më të lartë dhe më të ulët, ndërsa në vendet e OECD kjo diferencë është 93 pikë, dhe në vendet fqinje nga 49 pikë në Shqipëri deri në 81 pikë në Serbi.
- Faktorë si niveli arsimor i prindërve dhe posedimi i kompjuterit në shtëpi në Kosovë nuk prodhojnë dallime të mëdha në performancë, ndërsa kohëzgjatja e edukimit parashkollor nuk është në korrelacion me performancën në PISA, si në Kosovë ashtu edhe në vendet fqinje dhe ato të OECD.

- Ndryshimi në performancë në Matematikë mes nxënësve të shkollave private dhe atyre publike në Kosovë është 34 pikë në favor të atyre private, por pas normalizimit sipas statusit socio-ekonomik, ndryshimi është 10 pikë në favor të shkollave publike. Për lokacionin, dallimi është 28 pikë më i vogël mes shkollave të qyteteve të mëdha dhe atyre rurale krahasuar me vendet fqinje dhe me OECD-në. Në vendet e OECD dhe në tri nga katër vendet fqinje, nxënësit në klasa me 31-35 kanë performancë më të mirë, ndërsa në Kosovë, klasat me 36-40 nxënës kanë rezultate më të mira.
- Indeksi i ankthit nga Matematika, i ndërtuar mbi qëndrimet e nxënësve ndaj të nxënësve të matematikës dhe disa faktorëve socio-ekonomikë e kulturorë, është dukshëm më i lartë në Kosovë krahasuar me vendet fqinje dhe me mesataren e vendeve të OECD. Çdo pikë e rritjes në indeksin e ankthit për nxënësit kosovarë sjell një ulje të performancës në matematikë prej 13 pikësh.
- Një përqindje e konsiderueshme e nxënësve në Kosovë tregojnë mungesë vetëbesimi për zgjidhjen e problemeve matematikore të thjeshta, të cilat supozohet të jenë të mësuara në klasat 1-9. Kështu, 37.6% e nxënësve tregojnë një mungesë të vetëbesimit për zgjidhjen e një ekuacioni elementar me një të panjohur, ndërsa 55.9% e nxënësve nuk janë të bindur se mund të kalkulojnë çmimin e shitjes së një produkti duke përfshirë taksën. Performanca në matematikë është në përputhje me nivelin e vetëbesimit të nxënësve.
- Një situatë e ngjashme vërehet në rastin e deklaramit për njohuritë në lidhje me disa koncepte themelore matematikore, ku performanca korrespondon me nivelin e njohjes së këtyre koncepteve. Si shembull, 43.2% e nxënësve nga Kosova raportojnë se kanë njohuri të mira dhe se e kuptojnë konceptin e pjesëtimit, ndërsa në vendet fqinje, kjo përqindje ndryshon nga 50.1% në Maqedoninë e Veriut deri në 65.2% në Serbi. Gjithashtu, një mungesë e theksuar e njohurive shihet rreth konceptit të sipërfaqes së rrethit, ku vetëm 30.3% e nxënësve në Kosovë thonë se e njohin dhe e kuptojnë këtë koncept, në krahasim me 43.9% në Shqipëri, 39.5% në Maqedoninë e Veriut, 43.2% në Malin e Zi dhe 46.2% në Serbi. Këto koncepte janë të përfshira në programin mësimor të matematikës për arsimin fillor dhe në atë të mesëm të ulët.
- Në përputhje me tendencat globale, si në Kosovë, ashtu dhe në vendet fqinje, vërehet një trend i qartë i zvogëlimit të të gjitha formave të bullizmit, që mund të jetë pasojë e angazhimeve të veçanta në këtë fushë, si nga ana e autoriteteve arsimore ashtu edhe nga institucionet jashtëshkollore. Megjithatë, vërehet se frekuenca e pesë nga gjashtë format e identifikuar të bullizmit është raportuar të jetë më e lartë në Kosovë krahasuar me vendet fqinje. Nxënësit që janë bullizuar (ngacmuar) më shpesh kanë performancë më të ulët në krahasim me ata që nuk janë bullizuar ose janë bullizuar më rrallë.
- Indeksi i klimës disiplinore, i formuar në bazë të përgjigjeve të nxënësve për pyetjet lidhur me disiplinën në klasë, rezulton të jetë më i ulët në Kosovë në krahasim me vendet fqinje. Pavarësisht se nuk zbulohet një lidhje e drejtpërdrejtë midis indeksit të klimës disiplinore dhe të performancës mesatare në matematikë, një përjashtim vihet re në rastin e vendeve ose ekonomive me performancë të lartë, si Japonia, Korea e Jugut, Singapori, Taiwan, Lituania dhe Zvicra, të cilat shfaqin vlera të larta në indeksin e klimës disiplinore.
- Në 2022, Kosova ka dedikuar 3.9% të BPV-së dhe 13.4% të shpenzimeve qeveritare totale për arsim, duke u renditur paksa poshtë standardeve të rekomanduara nga UNESCO. Megjithatë, krahasuar me vendet e tjera në rajon, Kosova nuk qëndron aspak keq në aspektin e përqindjeve të alokimit të fondeve, edhe pse mbetet poshtë mesatares së vendeve të OECD-së. Edhe pse

rëndësia e investimit në arsim është e pakontestueshme, të dhënat tregojnë se vetëm shtimi i shpenzimeve nuk garanton përmirësimin e performancës së nxënësve në testet ndërkombëtare si PISA.

- Raporti mësimdhënës nxënës në shkollat e Kosovës është 13.9, pak mbi mesataren e PISA prej 13.2. Zvogëlimi i vazhdueshëm i këtij raporti në dy dekadat e fundit, si rezultat i zvogëlimit të numrit të nxënësve, nuk ka rezultuar me përmirësim të performancës së sistemit të arsimit. Po ashtu, struktura kualifikuese e mësimdhënësve në shkollat e përfshira në testin PISA është afër standardeve të OECD dhe mbi standardin e vendeve fqinje. Megjithatë, nëse shkollat në Kosovë do të kishin një rritje prej 10 njësi të përqindjes në numrin e mësimdhënësve të kualifikuar - duke arritur në 92.8% nga 82.8% që është aktualisht - përmirësimi në performancën në matematikë do të ishte minimal, vetëm një pikë, ndërsa, pas normalizimit për statusin socio-ekonomik do të ishte 0 pikë.
- Organizimi i trajnimeve për mësimdhënës është i ndërlidhur me performancën e nxënësve në matematikë, si në Kosovë ashtu edhe në vendet e OECD. Megjithatë, një dallim kryesor mes Kosovës dhe vendeve të OECD është përqindja e shkollave që mbajnë trajnime: në Kosovë, kjo përqindje ndryshon nga 45% në 55%, ndërsa në vendet e OECD ajo është ndërmjet 70% dhe 82%.
- Në shkollat e Kosovës ku drejtorët raportojnë se mungojnë materialet mësimore në një masë të konsiderueshme e ku vijojnë mësimet më shumë se 70% e nxënësve që kanë marrë pjesë në testin PISA, është një shifër që tejkalon mesataren e vendeve të OECD-së dhe të vendeve fqinje të Kosovës. Gjithashtu, 69.1% e nxënësve në Kosovë ndjekin mësimet në shkollat ku drejtorët theksojnë se materialet mësimore janë joadekuate ose të pakënaqshme për nga cilësia. Indeksi i mungesës së burimeve materiale, i krijuar nga përgjigjet e drejtorëve në disa pyetje konkrete rreth kësaj teme, është i barabartë me 1.00 në Kosovë dhe, si i tillë, më i lartë se në vendet fqinje. Vetëm pesë shtete/ekonomi pjesëmarrëse kanë një indeks më të lartë se Kosova: Xhamajka me 1.02, Mongolia me 1.09, Autoriteti Palestinez me 1.14, Maroku me 1.26 dhe Kostarika gjithashtu me 1.26.
- Analiza e të dhënave tregon dallime të konsiderueshme mes shkollave në kategorinë e shkollave të cënueshme, atyre me një përqindje të lartë nxënësish nga familje me gjendje të dobët socio-ekonomike, dhe të shkollave të favorizuara. Për shkollat e cënueshme në Kosovë, indeksi është 1.35, që është më i lartë se mesatarja e vendit prej 1.00, ndërsa për shkollat e favorizuara indeksi është vetëm 0.54. Gjithashtu, vërehet një ndryshim edhe më i theksuar mes shkollave publike dhe atyre private, ku të fundit shfaqin një indeks me vlerë negative. Kjo tregon një mungesë shumë më të vogël të materialeve mësimore në shkollat private krahasuar me ato publike.
- Sa i përket vendndodhjes së shkollës, drejtorët e shkollave urbane raportojnë se nevojat e tyre për burime materiale janë më pak të përmbushura në krahasim me ato në zonat rurale. Kjo mund të shpjegohet me zvogëlimin e vazhdueshëm të popullsisë shkollore në Kosovë, i cili, së bashku me investimet në burime materiale, ka mundësi të ketë kontribuar në përmirësimin e kushteve të punës në zonat rurale.
- Analiza e të dhënave tregon një lidhje të qartë në vendet e OECD mes disponueshmërisë dhe cilësisë së burimeve materiale dhe të suksesit të nxënësve në matematikë. Megjithatë, në Kosovë kjo tendencë nuk është aq e qartë. Përkundrazi, vërehen variacione që nxisin pyetje të reja, të cilat kërkojnë zgjidhje përmes hulumtimeve më të detajuara.

- Rënia e theksuar në rezultatet e PISA 2022 në krahasim me ato të PISA 2018 lë të kuptohet se pandemia e COVID-19 mund të ketë qenë një faktor ndikues në këtë tendencë negative. Sidoqoftë, analiza e tendencave të performancës në PISA para vitit 2018 zbulon se rezultatet në Lexim dhe në Shkencë kanë nisur të dobësohen kohë të gjatë që para shpërthimit të pandemisë. Kjo sugjeron se në rezultatet e PISA kanë ndikuar edhe faktorë të tjerë afatgjatë. Ndërsa në një numër shtetesh/ekonomish performanca e nxënësve ka mbetur e qëndrueshme ndër vite, në disa të tjera është vërejtur edhe një trend përmirësimi. Prandaj, ndikimi i pandemisë, edhe pse i dukshëm në rezultatet e fundit të PISA-s, nuk duhet të shihet si i vetmi shkaktar i rënies së performancës.
- Analiza e rezultateve të PISA 2022 tregon se nxënësit që nuk kanë pasur probleme teknike për pjesëmarrje në mësimin në distancë, siç janë problemet me sigurimin e kompjuterit, problemet e qasjes në internet dhe sigurimi i ndihmës me detyrat e shkollës, kanë treguar performancë dukshëm më të mirë sesa nxënësit që kanë raportuar probleme të kësaj natyre. E njëjta vlen për nxënësit që kanë raportuar se gjatë kohës së pandemisë kanë arritur t'i tejkalojnë me sukses disa probleme që lidhen me mirëqenien personale, si ndjenja e të qenit i/e vetmuar, ankthi lidhur me detyrat e shkollës dhe ngecja në detyrat e shkollës.

11. Rekomandimet

Rezultatet e nxënësve kosovarë në PISA reflektojnë gjendjen aktuale të sistemit arsimor në Kosovë. Në këtë kontekst, fokusimi i përpjekjeve për përmirësim duhet të zhvendoset nga arritja e rezultateve më të mira në testet PISA dhe në teste të tjera ndërkombëtare, drejt përmirësimit të gjendjes në sistemin arsimor. Performanca në Lexim, Matematikë dhe Shkencë që zbulohet nga PISA flet për aftësinë e nxënësve që të zbatojnë njohuritë e fituara gjatë viteve të mëparshme të shkollimit deri në moshën 15-vjeçare, që për Kosovën do të thotë gjatë periudhës së arsimit të detyruar dhe, eventualisht, një gjysmëvjetori të klasës së 10-të. Por PISA është më shumë se kaq. PISA përbën një studim kompleks që, përveç vlerësimit të njohurive dhe të aftësive të nxënësve, grumbullon të dhëna për gjendjen në familje, shkolla dhe komunitete, si dhe për perceptimet dhe qëndrimet e nxënësve, mësimitdhënësve, drejtorëve të shkollave e të prindërve, përmes anketave specifike. Ky proces mundëson analizën e thelluar të performancës së nxënësve në lidhje me të dhënat e mbledhura dhe lejon daljen me përfundime të rëndësishme që mund të drejtojnë formulimin e politikave arsimore.

Në përgjigje të sfidave dhe të nevojave të identifikuara nëpërmjet analizës së rezultateve të nxënësve kosovarë në PISA, si dhe në bazë të informacioneve të mbledhura nga anketat përcjellëse dhe burimet tjera, në vijim prezantojmë disa rekomandime në funksion të përmirësimit të gjendjes.

1) Përmirësimi dhe modernizimi i kurrikulave dhe materialeve mësimore

- Rishikimi i thellë i Kornizës së Kurrikulës së Kosovës, kurrikulave bërthamë, si dhe planeve dhe programeve mësimore, që të garantohet koherencë ndërmjet tyre dhe të sigurohet që zbatimi i përmbajtjeve të planifikuara mësimore të çojë në arritjen e rezultateve të të nxënësve dhe zhvillimin e kompetencave kyçe të nxënësve.
- Rishikimi i teksteve shkollore, me qëllim që ato të shërbejnë si mjet efektiv në arritjen e qëllimeve dhe objektivave të kurrikulës. Procesi i seleksionimit të teksteve shkollore duhet të organizohet në mënyrë që të lejojë zgjedhjen e materialeve më të përshtatshme dhe të dobishme për nxënësve.
- Zhvillimi i udhëzuesve praktikë për zbatimin efektiv të planeve dhe të programeve mësimore. Këta udhëzues do të ofronin një orientim të qartë për mësimitdhënësve, por edhe për autorët dhe shtëpitë botuese, duke garantuar kështu një koherencë më të fortë midis kurrikulës dhe mësimitdhënies e midis përmbajtjes së teksteve shkollore.

2) Forcimi i mekanizmave të brendshëm dhe të jashtëm për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar

- Riorganizimi i strukturave menaxhuese në shkolla duke forcuar rolin e aktiveve profesionale brenda institucioneve dhe të koordinatorëve të cilësisë, me qëllim të rritjes së efikasitetit e të përgjegjësisë në organizimin e procesit mësimor.
- Implementimi i vlerësimeve të rregullta të jashtme të shkollave nga Inspektorati i Arsimit, duke përdorur rezultatet e tyre si një mjet kyç që të identifikohen nevojat e përmirësimit dhe të ndërmerren veprime konkrete për ngritjen e standardeve të arsimit.
- Shtimi i besueshmërisë dhe i vlefshmërisë së testeve kombëtare si një instrument vital për sigurimin e jashtëm të cilësisë, duke shërbyer si mjet për stimulimin e llogaridhënies në nivelin e shkollës dhe për nxitjen e përmirësimit të vazhdueshëm të proceseve dhe të rezultateve mësimore.

3) Furnizimi i shkollave me mjete dhe materiale mësimore të përshtatshme

- Vendosja e standardeve të qarta për furnizimin e shkollave me mjete dhe materiale mësimore që të garantohet një bazë e fortë dhe uniforme e burimeve për të gjitha institucionet arsimore duke siguruar kështu qasje të barabartë në resurset e nevojshme për mbështetjen e mësimdhënies dhe të nxënies efektive.
- Furnizimi i shkollave me pajisje dhe teknologji digjitale, sipas planifikimeve të përcaktuara në Strategjinë e Arsimit 2022-2026, që të sigurohen infrastrukturë dhe resurse teknologjike të përditësuara e në përputhje me kërkesat e procesit mësimor dhe nevojat e nxënësve, duke krijuar kështu një mjedis optimal për mësimdhënie cilësore.

4) Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies në shkolla

- Rishikimi gjithëpërfshirës dhe i vazhdueshëm i programeve të përgatitjes fillestare të mësimdhënësve në institucionet e arsimit të lartë, me qëllim të përshtatjes së tyre me nevojat aktuale dhe të ardhshme të sistemit arsimor. Përqendrimi duhet të jetë në metodat e mësimdhënies që promovojnë përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie, të menduarit kritik dhe aftësitë e zgjidhjes së problemeve.
- Mbështetja e zhvillimit profesional të vazhdueshëm të mësimdhënësve përmes sigurimit të qasjes në programe të akredituara të zhvillimit profesional dhe duke siguruar mbulimin financiar të plotë për pjesëmarrjen në këto programe. Kjo mundëson përforcimin e kompetencave dhe aftësive të mësimdhënësve për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe të qenit në përputhje me kërkesat e vazhdueshme të sistemit arsimor.
- Funkcionalizimi i sistemit të licencimit për mësimdhënësit, i cili jo vetëm që garanton standarde të larta profesionale dhe përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies, por edhe stimulon mësimdhënësit për zhvillim profesional përmes lidhjes së drejtpërdrejtë të avancimit në karrierë me sistemin e pagave.

5) Përmirësimi i klimës disiplinore në shkolla

- Inkurajimi dhe mbështetja e ndërtimit të marrëdhënieve të forta dhe pozitive ndërmjet mësime-dhënësve dhe nxënësve, të cilat mund të ndihmojnë në uljen e sjelljeve problematike.
- Zbatimi i politikave të qarta për menaxhimin e sjelljeve problematike, duke siguruar që masat disiplinore të jenë të përshtatshme me natyrën dhe me rëndësinë e sjelljes, dhe të kryhen në mënyrë transparente e me respekt ndaj të drejtave të nxënësve.
- Organizimi i sesioneve edukative dhe fushatave sensibilizuese që të ngrihet ndërgjegjësimi rreth pasojave negative të bullizmit dhe sjelljeve të tjera abuzive.
- Nxitja e bashkëpunimit dhe angazhimit të prindërve dhe e anëtarëve të komunitetit në aktivitetet e shkollës për mbështetjen e një mjedisi më të sigurt dhe më disiplinor shkollor.
- Përdorimi i anketave dhe i mjeteve të tjera vlerësuese për monitorimin e ndryshimeve të klimës disiplinore të shkollës dhe për identifikimin e nevojave për ndërhyrje shtesë.

6) Rishikimi i sistemit të financimit në arsimin parauniversitar

- Aprovimi i formulës së re të financimit për arsimin parauniversitar, e cila duhet të sigurojë burime financiare të mjaftueshme që të mbulohen jo vetëm shpenzimet operacionale të shkollave, por edhe shpenzimet shtesë për riorganizimin e strukturës menaxhuese, furnizimin me materiale dhe mjete mësimore të nevojshme, si dhe për ngritjen e cilësisë së mësimdhënies. Për më tepër, është thelbësore të përfshihet një mekanizëm i qartë dhe efektiv për monitorimin dhe kontrollin e shpenzimeve, për garantimin e përdorimit efikas dhe transparent të fondeve.
- Zgjerimi i autonomisë financiare të institucioneve arsimore nëpërmjet aprovimit dhe zbatimit të legjislacionit të përshtatshëm duke u lejuar shkollave të menaxhojnë me më shumë efikasitet burimet financiare në përputhje me nevojat dhe prioritetet e tyre specifike. Kjo përfshin autonomi në vendimmarrjen për alokimin e buxhetit për zhvillimin profesional të stafit dhe sigurimin e mjeteve të nevojshme mësimore.
- Racionalizimi i rrjetit të institucioneve arsimore me qëllim të efikasitetit më të madh dhe të ofrimit të arsimit cilësor. Kjo mund të përfshijë bashkimin e institucioneve të vogla arsimore në njësi më të mëdha, për sigurimin e një oferte më të pasur mësimore për të gjithë nxënësit, duke ofruar, sipas nevojës, transportin për nxënësit dhe personelin.

